Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

Kuvendi i Komunës
-Kryesuesi i Kuvendit-

01Nr._____
Kaçanik, 18.09.2026

FTESË PËR MBLEDHJE

Të nderuar Anëtarë të Kuvendit të Komunës,

Në bazë të nenit 43 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, e thërras mbledhjen e VIII (tetë) të rregullt të Kuvendit të Komunës Kaçanik, për vitin 2026.

Mbledhja do të mbahet në sallën e kuvendit të komunës, në katin e tretë të objektit të komunës, me 29.09.2026 (e martë) në ora 11:00.

Mbledhjen do ta kryeson dhe udhëheq, Selajdin Troni, Kryesues i Kuvendit.

Ju mirëpresim!

Me respekt!

Kryesuesi i Kuvendit
Selajdin Troni
_____

Në mbledhjen e VIII (tetë) të rregullt të Kuvendit të Komunës, të datës 29.09.2026, do të shqyrtohet ky:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Raporti Gjashtëmujor i KKSB për periudhën janar- qershor;
3. Propozim-vendim për Buxhetin e Komunës së Kaçanikut për vitin fiskal 2027 dhe vlerësimet për vitet 2028-2029 - për shqyrtim dhe aprovim;
4. Raport Periodik për zbatimin e rekomandimeve për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Kaçanikut për vitin 2025
5. Propozim-Vendim paraprak për dhënien e pronës së paluashtëshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite;
6. Propozim Vendim për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite të pronës se paluajtëshme të Komunës;
7. Informatë për përfundimin e vitit shkollor 2025-2026;
8. Informatë fillimi i vitit të ri shkollor 2026-2027 në Komunën e Kacanikut;
9. Plani Komunal për ri-integrimin e qëndrueshëm të personave të Riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Kacanikut;
10. Propozim Vendim për Miratimin e raportit përfundimtar mbi vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga reshjet e breshërit;

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal of Kacanik

01Nr. 060/01-18613/2026
Kaçanik, 30.07.2026

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **VII (shtatë)** e rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2026 (Legjislatura e 8), mbajtur me 30.07.2026 (e enjte), në katin e tretë, në sallën e kuvendit, më fillim pune në ora 11:00.
Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendi i Komunës prej 21 anëtarëve, pjesëmarrës në mbledhje fillimisht ishin 19 anëtarë, në ndërkohë arriti anëtari Betim Shala. Konstatohet se pjesëmarrës të kësaj mbledhje ishin 20 anëtarë. Mungoj me arsye 1 anëtarë: Hafize SallahuNga Ekzekutivi i komunës morën pjesë: Kryetari i Komunës, Nënkryetari i Komunës, 09 drejtor të drejtorive. Nga zyrtarët: Zyrtari i IT, Asistentja e Kryesuesit të KK dhe këshilltarja e kryetarit.
Mbledhja ka qenë në transmetim të drejtpërdrejtë.
Mbledhjen e kryesoj, Selajdin Troni, Kryesues i Kuvendit
Procesmbajtës, Arianita Bajrami – Asistente e Kryesuesit të Kuvendit .

Kryesuesi i Kuvendit - Selajdin Troni: Së pari i përshëndeti të gjithë të pranishmit, iu dëshiroi mirëseardhje, konstatoj kuorumin duke i thirrur me emër, një anëtar, Hafize Sallahu mungon me arsye. Kushtet pune me u mbajtur mbledhja ka, e hapi mbledhjen e VII-të të Rregullt të Kuvendit të Komunës për vitin 2026 të Legjislaturës së 8, data 30.07.2026, me këtë:

z. Selajdin Troni:, vazhdojmë me rendin e ditës:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit Komunal;
2. Propozim –Vendimin për miratimin e Planit Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave Për Rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt;
3. Propozim Vendim për rialokimin e mjeteve buxhetore sipas Buxhetit të vitit 2026;
4. Raporti Gjashtëmujor Financiar për periudhën 01.01.2026 - 30.06.2026;
5. Plani i Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të Raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Kaçanikut për vitin 2025;
6. Propozim-Vendim për shpalljen në interes publik të parcelave kadastrale në ZK, Elezaj;

7. Propozim-Vendim paraprak për dhënien e pronës së paluajtëshme të komunës në shfrytëzim afatshkurtër;

8. Propozim-Vendim për Formimin e komisionit të ankesave për procedurën e dhënien në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtëshme të komunës;

9. Propozim-Vendim për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtëshme të komunës.

10. Kërkesë nga MAPL për shqyrtimin e vendimit 01Nr.104/02-11476/26 për aprovimin e strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal për Komunën e Kacanikut.

Lidhur me rendin e punës, e hapi diskutimin,

Aprovoj

Rendin e punës në përbërje prej 10 pikave.

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;

z. Selajdin Troni: A ka dikush dicka rreth procesverbalit?

Heset Malsiu: Procesverbali është shumë i mangët tek pjesa ime, nëse ka mundësi ta dërgoj për përmirësim pjesën.

Jeton Luma: Njejtë edhe unë**.**

Selajdin Troni: në rregull d.m.th me plotësim ndryshime e hudhim në votim procesverbalin e mbledhjes së kaluar

APROVOJ

Procesverbalin nga mbledhja VI (gjashtë) e rregullt e KK, e legjislaturës së 8, për vitin 2026, të datës 29.06.2026

Pyetje dhe Kërkesa

Jeton Luma: Sot dua te ndalem ne fushen e Kultures, dhe dua te them se komuna ka investuar fare pak në këte fushë për të mos thënë fare. Shumë monumente janë lënë pas dore dhe po dëmtohën cdo ditë e më shumë, si shkak i mungesës së invëstimëve dhe mos mirëmbajtjes. Shtëpia e Kulturës në fshatin Glloboqicë, kërkoj që të bëhet renovimi i plotë i objektit. Të krijohet një qendër rinore dhe një zyrë për administratorin e fshatit. Kemi mungesë të hapsirës për të rinjët në fshat.
Meqenëse shkolla e fshatit mbanë emrin e heroit "Avdylgafurr Luma" kërkoj që shtëpisë së Kulturës ti vendoset emri i heroit tjetër "Osman Luma".

Ardita Rrahmani: Kam disa kërkesa, banorët e fshatrave Ivajë e Shtrazë janë tejet të shqetësuar per rrugën dhe kërkojnë të dinë kur do të intervenohet për rregullimin e saj. Banorët e Lagjes Caka (konkretisht Muhamet Zeneli) kërkojnë vendosjen e një pasqyre konvekse tek dalja e lagjes apo konkretisht në kyqjen e magjistrales.

Islam Gashi: Ankesë mbi ndarjen e parceles për vorrezat e fshatit, shumë lagje janë detyruar të ndajnë parcela private, varrezat ekzistuese janë të mbushura dhe lutem që kjo

punë të merrët seriozisht.

Sabedin Vishi: Vendimi për ndarjen e parcelës për vorreza në fshatin Begracë është që nga 2016, mirëpo ka ankesa nga qytetarët e tjerë që nuk janë marrë nënshkrimet nga të gjithë d.m.th. nga mosmarrvëshjet e banorëve.

Kjani Zeneli: Kam tri kërkesa, i kam dhe me video,
Në lagjen Dushkaja, tek shtëpia e mësuesit Behlul Shehu, shiheni se si i futen ujrat atmosferik ne oborr.
Në fshatin Gjurgjudell tek Avdi Bela, investitor nga diaspora, vërshimet e fundit i janë futë në fermë.
Zona turistike Sharr në fshatin Shtrazë nuk ka drita në mbrëmje, lutem qe të merren masa.

Kadrije Lika Troni: Kam një shqetësim për drejtorinë e Kulturës, Kalaja e Kacanikut ska mirëmbajtje dhe është në gjendje alarmante, ka gurë të rënë nga muri i Kalasë, gjelbërimi i pakontrolluar dhe pamirëmbajtur po rrezikon strukturën e monumentit, Kalaja është identiteti ynë kështu që kërkoj që më urgjencë që të intervenohet në këtë pjesë.

Buletin Guri: Punimet ne cerdhen e fshatit Nikaj janë në përfundim kam një pyetje se a ka Komuna ndonjë plan të instaloj sinjalizim horizontal dhe vertikal në rrugën tek cerdhja. Dhe cfarë hapa po merrni ju për finalizimin e këtij projekti.

Jeton Luma: Herën e kaluar bëra një pyetje për zyren e vendit në Glloboqicë, më thatë që po funksionon, nuk është funksionale sic di unë, më thatë që do marr përgjigje me shkrim por nuk kam marrë.

Ardita Rrahmani: Po më intereson me ditë se impianti i ujrave të zeza në Ferizaj, me njohuritë e mija, zgjidhja tash e dy vite qëndron në sirtaret e MF, ku nuk nënshkruhet nga ministri, dua të di se cka po ndodhë, a duhet të bëhet trysni edhe më e madhe si komunë.

Sabedin Vishi: E kemi pa ne rrjete sociale edhe ne, kemi pas takime edhe me shefin e Bifurkacionit për këtë cështje, ato që janë kërku nga në janë të gjitha në rregull, barrën financiare e ka komuna e Ferizajit, ata kanë nda mjete por sic dimë është në procedurë por vazhdojmë me pritë.

Kadrije Lika Troni: Më herët e kishim votu një pjesë të parcelës për ndërtimin e impianit në Kacanik të Vjetër. A jeni në në kontakt me kryetarin e Ferizajit lidhur me kete cështje.

Sabedin Vishi: Është nënshkruar marrveshje mes nesh, këtë obligim e ka detyrim Ferizaji e fizibilitegin e projektim është dukee e udhëhequr Bifurkacioni, prap do shkoj edhe njëherë ekstra për këtë punë.

2. **Propozim –Vendimin për miratimin e Planit Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave Për Rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt;**

E hapi diskutimin drejtor:

Arian Teneqja: Plani Ndërkomunal për menaxhimin e Mbeturinave është bërë për rajonin e 5, është plan voluminoz që na është kërkuar të votohet në Kuvend, për të mirën e këtyre qyteteve.

Jeton Luma: Mesa e pashë parashihet që në vitin 2027 pagesa do rritet për dy euro, a mund të na tregosh sa qëndron kjo.

Arian Teneqja: Jo kjo nuk qëndron, kjo ka pasë nevojë të vendoset për planifikim dhe nuk do të thotë që do të jetë ashtu.

Kadrije Lika Troni: Uroj që të zbatohet në praktikë, unë dua të di se kush mban përgjegjësi për monitorimin e këtij në nivel komunal, a mban përgjegjësi DShPE, Pastërtia apo Komuna e Kacanikut.

Arjan Teneqja: Është plan ndërrajonal, duke përfshirë disa komuna, plan me kosto shume te lartë financiare 2026/30, kjo duhet të ketë përkrahje nga niveli qëndror. DShPE është përgjegjëse për implementimin e tij.

Kadrije Lika Troni: Ku është mëndu të bëhet oborri i riciklimit ne Kacanik, a është mendu në këtë plan.

Arjan Teneqja: Kjo është mendu të jetë e përbashkët, nuk ka të paraparë për në komunën tonë përvec oborr transferi apo grumbullimi.
Në bazë të viteve të kaluara janë menduar me përpikëmëri këto.

Xhelal Ceka: Desha të ndërlidhem se këtu është parapa si ndarje e mbeturinave dhe të gjindet një vend regjional për Riciklim, kemi në Gërlicë një deponi që nuk përdoret më, por në Mirash.

Kadrije Lika Troni: Ka biznese në komunën e Kavanikut qe nuk kanë as kosh mbeturinash por paguajnë si të gjithë, por edhe veprimtaritë që i ushtrojnë janë pa mbeturina, të bëhet një zgjidhje pak më e volitshme për të gjithë.

Xhelal Ceka: Jo vetëm që du me ja lënë nivelit qëndror fajin por e kemi fitu një grant prej 110 mijë eursh nga performanca e mirë, që ministria është dashtë ti ekzekutoj ku është parapa që ti shpenzojmë për një kamion dhe për kontinjera por nuk kanë ecë procedurat, por ministria nuk i ka pa të arsyeshme. Kemi pasë përfaqësues nga VV dhe nga PDK por nuk kanë ndihmuar aspakt, vetëm pagën mujore e kanë marrë.

Kadrije Lika Troni: Nuk desha te dal në nivel qëndror, bizneset paguajnë Pastërtinë por nuk kanë kontirjera.

Xhelal Ceka: Kur të doni dalim dhe pyesim qytetarët, u kam ofruar për dy muaj ditë shërbime pa pagesa vetëm që klienti ta marrë kontinjerin e vetë por nuk kanë shpreh dëshirë, ky vendim sështë leju këtë e kam bë unë vetë si menaxher. Te ne vec një javë mos më i marrë mbeturinat shihet rezultati, më vjen keq qe sillen cdo ditë tek zyra dhe kanë kërkesa për kontinjera por ne nuk kemi financa.

Ernesta Krasniqi: Xhelali pe shpreh gatishmërinë për përgjigje po i drejtohem, përvec

komisionit që po thuhet se ska ndihmu askush, ky komision paguhet nga Pastërtia me sa di unë, ju si menaxher pse nuk keni kërku apo bë një ankesë se këta anëtarë nuk po kryejnë punën sic duhet dhe si kishi pagu, the se kanë marrë pare dhe skanë ndihmu, pse me pagu anëtarë që nuk kryejnë funksion.

Xhelal Ceka: Unë si ish menaxher, unë menaxhimin e kam kry vetë nuk kam pas nëvojë për ndihmë por thash se nuk e dinë se cfarë pune bëjmë anëtarët nga ky kuvend.

Sabedin Vishi: Tek cështja e kontinjerave, ne nuk kemi ndonjë ankesë me shkrim, e di që ka probleme dhe arsya e tyre është që mjete financiare aktualisht nuk kanë, një prej shpenzimeve është ndalimi i deponisë në Gërilicë, dhe i dërgojnë në Gjilan. 100% objektivat nuk mundet me i arrit asnjë organizatë. Ne po kontribuojmë në këto probleme që mund ti kenë KRM Pastërtia. Ndër komuna jemi më së miri në këtë drejtim, tek bizneset nëse ka ankesa është mirë me na tregu.

Kadrije Lika Troni: A shkon kontinjeri dërgesa varësisht nga lokali i vogël, nga veprimtaria, apo është obligim ta ketë, edhe ky propozim për marrëveshje me biznese dhe Pastërtinë, me ndihmu edhe biznesin por edhe si pagues i rregullt të mos ndëshkohet.

Arjan Teneqja: Ne si DShPE, momentin që qytetarët kanë ankesa ata janë të lirë të vijnë dhe të drejtojnë tek ne, ju kisha lut të kthehemi në temë.

Jeton Luma: sa i përket ankesave si koncept bazë është e drejta e shprehjes dhe secili e kemi këtë të drejtë.

Selajdin Troni: Jua kemi dhënë këtë mundësi sa keni deshtë. A ka dikush rreth kësaj pike me shtu dicka, nëse nuk ka athërë e hedhim për aprovim. 20 për, Prezent ishin 20, me këtë rast Kuvendi konstatoj se mori:

VENDIM
për miratimin e Planit Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave Për Rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt;

3. Propozim Vendim për rialokimin e mjeteve buxhetore sipas Buxhetit të vitit 2026;

Valdrin Dogani: Prej një projekti kapital mjetet janë bart më një projekt tjeter brenda planit buxhetor, bëhet fjalë për lëvizjen e mjeteve nga asfaltimi i rrugës Hamzë Jashari Silgapor-Rakaj. Ne atë Qemajl Guri, arsyeja është se në projektin paraprak kemi pasë të buxhetuar 70mijë Euro, 50 mijë euro nga qeveria nuk kanë bë të pamundur investimin kapital, pjesën tjetër e kemi rialoku në mënyrë që rruga të plotësohet me trotuarë dhe ndricim. Përmes këtij sqarimi kërkoj që të votohet ky rialokim.

Bashkim Krasniqi: Sa i përket alokimit të mjeteve projekti "Hamzë Jashari" ka qenë i rëndësishëm por me qenë se kontrata kolektive ka me na vonu shumë projekte po më vjen mirë qe po rialokohen mjetet te rruga Qemail Guri, ne jemi pro kti rialokimi.

Kadrije Lika Troni: Pse projekti Hamzë Jashari nuk ka nisur fare, kur ka qenë i planifikuar dhe a janë njoftuar banorët e atij segmenti qe nuk do të rregullohet rruga e tyre, cilat janë kriteret që keni vendosë se cila rrugë është më prioritare.

Bashkim Krasniqi: aty nuk ka banorë fare.

Valdrin Dogani: Në atë segment nuk ka banorë, ne nuk kemi mujt me nis projektin sepse janë terhjek mjetet nga departamenti i thesarit. Përndryshe ne veq e kemi përfshi në fillimin e procesit buxhetor 250 mijë total euro për tri vite.

Kadrije Lika Troni: Nëse bëjmë rialokimin a do largohet fare si projekt ky?

Islam Gashi: Projekti thekson se marrja e 20 mijë euro nuk e rrezikon fare projektin sepse nuk ka nisur fare si procedurë nga prokurorimi, a po e pranoni këtë që ky projekt ska pasë me u realizu në këtë vit edhe nëse nuk kishin me u marrë këto vendime.

Valdrin Dogani: Mjetet buxhetore që po rialokohen janë mjete të paangazhuara, ne po i vendosim diku që ta bëjmë punën sic duhet. Kam një pyetje për ty Islam a e din datën kur është votu ligji i buxhetit, pa i pas fondet në dispozicion nuk mundesh me iniciu, sapo janë alokuar mjetet janë tërhjekur.

Ernesta Krasniqi: A ka projekt për rrugën Qemajl Guri dhe a ka një vlerë për këtë rrugë?

Valdrin Dogani: për projekt po ja jap fjalen drejtorit DShPE.

Buletin Guri: Rruga Qemail Guri është projekt i premtuar disa herë rradhazi, projekti ka qenë që rruga të mos bëhet e pjerrët, a do ketë sigurtë trotuarë dhe ndricim publik, nëse po unë jam për.

Arjan Teneqja: Kur e kemi pa mungesën e mjeteve dhe po dështon si projekt për këtë vit, ne kemi ripërpunuar projektin për rrugën Qemajl Guri, dhe pjerrtësia dhe rregullat janë në bazë të komunikacionit.

Ernesta Krasniqi: Planifikimi dmth ka qenë gabim herën e parë, a është 36 mijë euro Planifikimi Buxhetor, investimet kapitale njëri projekt me 0% realizim është 36 mijë euro, dmth planifikimi Buxhetor ska qenë i saktë, dmth sju kanë dal ato, tash pju duhen edhe 20 mijë tjera.

Valdrin Dogani: Në ligjin e buxhetit ndarja eshtë bërë në dy vite, pas dështimit të projektit paraprak që ta kryejmë më shpejtë po i rialokojmë.

Sabedin Vishi: Zakonisht kur planifikohen OBK, asnjëherë nuk e qesim në asnjë projekt komplet grant, arsyeja se nëse i ndajmë 100 mijë euro, hyn dikush me 80 mijë euro atëherë ne e rrezikojmë grantin duke e mbështetë dhe me HV-këtë, hala pa fillu procedura thesari ka marre pjesë të mjeteve dhe pas marrjes së atyne mjeteve i kemi kompletu nje projekt tjeter që të kryhet për një vit, sa i përket premtimit ai është bërë në tetor dhe po realizohet sivjet.

Jeton Luma: Ka qenë e paraparë me 36 mijë Euro dhe 40 mijë euro ti shtohen sa është tërsia e shumës qe do ta mbuloj, a i bie 56 mijë euro?

Valdrin Dogani: Unë po kërkoj mbështetje, qëllimi është të bëhet rruga e kompletuar, përndryshe për projekt din drejtori më shumë.

Arjan Teneqja: thash më herët se do të vazhdohet rruga 6m dhe trotuari 1.5m

Selajdin Troni: Nëse nuk ka dikush dicka e hedhim pikën në votim. 15 për/ kunder/ 5 abstenim. Prezent ishin 20, me këtë rast Kuvendi konstatoj se mori:

VENDIM
Vendim për rialokimin e mjeteve buxhetore sipas Buxhetit të vitit 2026

4. Raporti Gjashtëmujor Financiar për periudhën 01.01.2026 - 30.06.2026;

Islam Gashi: Dobsitë më të mëdha të këtij raporti janë investimet kapitale, janë realizu vetëm 29.83, duke shpenzuar vetëm 956 mijë 678 euro nga 52.6 nuk janë investime kapitale por pagesa për vendime gjyqësore, investimet reale kapitale janë vetëm 14.1% e buxhetit total. Shifër alarmante!
Kemi një rënje nga viti i kaluar47.6% me 29.3%. Tatimi në pronë është inkasuar vetëm 21.39% e planit, kjo nuk është hera e parë që ndodh, e njejta gjë ka ndodhur edhe vitin e kaluar. Në tabelën 11 te projekteve kapitale shohim shumë projekte jetike që kanë 0% realizim. Rasti i bujqësisë shohim se subvencionet dhe investimet kapitale shohim që ska shpenzime edhe ato shërbime kulturore skanë shpenzuar asgjë.
Buxheti aktual në tabelën 1 është shënuar se është 13 milionë 405 mijë e 993 euro ndërsa në tabelën 4 është 13 milionë 399 mijë e 753 euro, njejtë me buxhetin filledtar.
Në tabelën 11 kodi projekti kapital, në fshatin Begracë, projekt 30 mijë eurosh është shtuar edhe një fshat dhe tani kemi edhe një kontratë në vlerë 22 mijë euro. Nëse kuvendi i kish nda këto mjetë vetëm për fshatin Begracë me cfarë të drejte është përfshirë dhe fshati tjetër, pse është premtuar shtrimi rrugëve e në kontratë shënon vetëm shtruarje me zhavor.

Valdrin Dogani: Të gjithë e dijmë që ligji i buxhetit na ka vonu, na ka vonu me i iniciu procedurat, ato kërkojnë afate e kohë, në momentin që ipet kontrata fillon realizimi. Gjatë raportit ndryshon kjo vlerë, përmes prokurorimit ne njoftohemi nga realizimi u projekteve, sa i përket inkasimit tek Tatimi në Pronë, e kemi kontaktu posten e Kosoves për shpërndarjen e postave në komunë,e cila na kanë njoftu që me datën 30 Qërshor ka pranu faturat, ketu tregon pse ka ra inkasimi. Kemi me reflektu tek rritja e inkasimit në 3 mujorëshin e tretë. Tek tabela 11, buxheti aktual është paraqit 2 herë sepse kemi prit se ka me u realizu edhe bartja e mjeteve vetanake paraprake. Veq është lënë e gatëshme me përfshi edhe këtë, më datën 13 korrik kemi pranu që është realizu.

Selajdin Troni: shkak i pagujdesisë nga lart ne po pësojmë.

Islam Gashi: Pse në tabelën numër 10 kemi tan ato projekte me 0% realizim. Sa ka gjasa që këto projekte që të mos realizohen?

Valdrin Dogani: Ligji i Buxhetit është bërë me vonesë, zyra e prokurorimit kërkon zotimin e mjeteve për inicim të projekteve.

Sabedin Vishi: tek cështja e rrugëve kemi fillu për herë të parë dhe e kemi marrë në fshatin ku punohet më së shumti toka në Begracë. Para se me nis procedurën, drejtori ka dalë në terren tek lagja Luzha, nuk kan ra në ujdi për zgjerimin e rrugëve andaj për mos me rreziku është lënë edhe në Biqec-Nikaj.

Islam Gashi: A ish dasht që me ardh ky rialokim në kuvend gjithësesi? Ky është projekt 3 vjecar, a ka me qenë vec për Begracë.

Sabedin Vishi: Ky planifikim ka qenë vec për Begracë, por viteve tjera vlen edhe per fshatrat tjera ku ka prioritet më shume dhe arsyeshmëri.

Islam Gashi: A ka drejtë ligjore kryetari apo drejtori me i transferu mjetet diku tjeter pa ardhë në kuvend me këto arsyetime.

Sabedin Vishi. Në moment që ec procedura, ka pasë pengesa por pjesa dërrmuese shkon prap në Begracë.

Jeton Luma: Pasi e shqyrtojmë këtë raportin du me u ndal edhe unë tek disa pika, pjesa ku duhet të vendoset theksi është tek investimet kapitali, kur merr shumën totale 3.2 milion euro është realizu vetem 29.83% nivel koxha i ulet i pjesës së parë të vitit, nëse e hjek edhe pjesën ku paguhen vendime gjyqësore realisht i bje vetëm 14% mirëpo përsëri për gjysmën e parë të vitit është tëpër pak, a kemi garancë që deri në fund të vitit do vazhdojënë projektet. Ka projekte të rëndësishme që nuk kanë fillu aspak.
Kjo vonesë tregon mospunën e administratës komunale. 300,000 euro janë të planifikuara pëe fushën e kulturës asnjë cent sështë realizu.

Heset Malsiu: Unë në këtë raport pashë inkasimin tek lejet ndërtimore që është më shumë se dyfishi se viti i kaluar që është zhvillim në Kacanik. Realizimi në vetëm 14% në investime kapitale uroj të mos jetë dita e mirë shihet në mëngjes, metëvërtet ky realizim na shqetëson të gjithëve, nuk e di si do tja dalim deri në fundvit.

Sabedin Vishi: Investimet Kapitale është e vërtetë që janë me shumë të ulët por këtu është i përfshirë vetëm gjashtë mujori i parë, për herë të parë kemi pas mjetet e ndara për të nisë procedurat e prokurimit. Të gjithë besoj që jeni në dijeni se buxheti është vonuar, asnjë investim kapital ska mbet pa inicuar, ajo cka ne po penalizohemi është nëse kemi ankesa mes operatorëve, përndryshe gjashtë mujori i parë gjithmonë ka qenë më i vështirë por sërish gjithmonë ia kemi dal të jemi 99.99% në shfrytëzim të grantit qeveritar. Rruga Runjevë-Stagovë ka qenë përfitim i grantit qeveritar nga performanca por e kemi humb shkak i operatorëve, vonesave nga ankesat. Nëse një projekt nuk është nis fare atëherë do të thotë që na ka ndalë kontrata kolektive. Për herë të parë e kemi nda për mirëmbajtjen verore dhe dimërore, trotuaret, kemi me nis me i mbush edhe disa gropa, rrugët urbane, kalldërmi, e të tjera.

Ardita Rrahmani- Projekti Runjevë- Stagovë, a ekziston një mundësi që si shkak i humbjes së këtij granti nga operatorët, ne si komunë a mundemi me ndërrmarë dicka apo ju si pjesë e asociacionit të komunave a është ndërmarrë dicka.

Sabedin Vishi: Shqetëzimet e njëpasnjëshme i percjellin sidomos kontrata kolektive ka qenë ajo e cila i ka dëmtu më së shumti gjitha komunat, por ne pakëz më mirë është që ne kemi mund me e bë një marrveshje me mësimdhënësit, e sa i perket rrugës kemi diskutu me ata të rezultatit të performances duhet të shpenzohet brenda atij viti.

Islam Gashi: Tek investimet kapitale ndryshimi nga 48% është bë 29% këtë vit, pasi që tre mujorëshin e parë thatë nuk është kryer asnjë projekt, tek rapoti financiar shkruan qe kanë qenë investi 451 mijë euro për investime kapitale veca tjeravr i bie qe 137 mijë janë shpenzuar për projekte që i bie se ka pasë projekte

Sabedin Vishi: Realisht ka pasë kontrata dy vjecare të cilat kemi pasë drejt me i vazhdu këtë vit.

Islam Gashi: Edhe te bujqësia e di që për bleta janë nda subvencione, edhe pse është e shënuar 0, te kultura 0 edhe pse janë nda rreth 300.000 euro.

Valdrin Dogani: E vërtetë që janë nda subvencione për bletarët por pagesa qshtë ekzekutuar në korrik, prandaj sështë përfshi, kemi dy projekte kapitale në pjesën e kulturës, janë të iniciuara procedurat. Ka me ndryshu gjendja në raportin nëntëmujor financiar andaj ka me qenë një shifër akoma ma e mirë.

Selajdin Troni: Nëse nuk ka dikush dicka vazhdojmë me pikën tjetër pasi që kjo kalon vetës si informatë:

5. Plani i Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të Raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Kaçanikut për vitin 2025;

Ernesta Krasniqi: Plani i veprimit, në parim ne jemi pro planit, ma e rëndësishmja është që ky plan të zbatohet por përderisa raporti i auditimit vjen me rekomandime të përsëritura ne nuk mundemi me vazhdu me votu plane të cilat mbesin veq plane e nuk zbatohen mos të harrojmë që pas raportit të vitit të kaluar kemi pas një plan veprimi por sa është zbatuar e kemi parë kur ka ardhë ky raporti i fundit ku ka edhe më shumë rekomandime. Ne nuk vazhdojmë ti votojmë planet.

Selajdin Troni: Nëse nuk ka dikush dicka vazhdojmë me pikën tjetër pasi që kjo kalon vetës si informatë:

6. Propozim-Vendim për shpalljen në interes publik të parcelave kadastrale në ZK, Elezaj;

Korab Krasniqi: Këtu kemi të bëjmë me një propozim për inicim për shpallje të parcelave me interes publik në ZK Elezaj, te cilat janë në pronësi private, kjo po bëhet me mundësi për zgjerimin e rrugës dhe krijimit të një rruge të re. Unë e kam përgatit edhe në formë digjitale, te cilën e shohim këtu, në rrugën aktuale ka të ndërtuara dy shtëpi kështu që nuk shfrytëzohet për cka është, prandaj këto shtëpi kanë vendos ta bëjnë një marrveshje që ta zhvendosin rrugën në pjesën e poshtme, pjesa me ngjyrë të kuqe, besoj që është e qartë si propozim dhe konsideroj që duhet të ecë si proces pasi që kështu aktualisht nuk përdoret si rrugë dhe të krijohet një zgjidhje më të mirë.
Normalisht e kemi si kriter që të marrim më shumë hapsirë se sa që ipet, që të krijohet një hapsirë më e madhe

Buletin Guri: Shpesh na vinë pika të ngjashme, si gabime të institucioneve, si ka mundësi që shtëpitë të mdërtohen nëpër rrugë, kjo i bie që zyrtarët komunal po korruptohen dhe është për keqardhje që nuk dalin inspektorët komunal, fatkeqësisht nuk ka pas asnjë distancim nga pjesëtarët e ekzekutivit pikërisht për rastin e tillë para dy javësh.

Korab Krasniqi: Këto shtëpi janë ndërtuar para lufte, kështu qe nuk e di sa kemi mundësi të marrim përgjegjësi për atë pjesë.

Kadrije Lika Troni- Desha të kërkoj se a është qekjo parcelë që ka ardhë si pikë e rendit të ditës por e keni tërhjek.

Korab Krasniqi: Unë kam konsideru se ka nevojë akoma për përmirësime

Kadrije Lika Troni: Unë personalisht këtu nuk shoh që ka ndonjë interes publik, ky është interes personal i banorëve të cilën kanë mund me e rregullu vetë, e me këmby ne toka këtu, ne ktu jemi për me dhënë këshilla, pse ne me dhënë pronë të komunës.

Selajdin Troni: pasi që janë koordinu kta banorët neve sna kushton asgjë për me e ec përpara

Korab Krasniqi: Unë mendoj që interesi i qytetarëve është edhe interes publik i komunës, kjo rrugë është e papërdorëshme, kta janë duke dhënë tokë të vetën, e cila bëhet pronë publike, unë nuk kam vullnet me i prish shtëpitë.

Kadrije Lika Troni: Në bazë të matrialit unë kam pa se komuna ka deshtë me dhënë 1000 metra më shumë që ta këmbej rrugën, andaj e ke tërhjek.
A mundesh me na tregu sa po marrim e sa po japim ne si komunë?

Korab Krasniqi: Kemi marr 1683 metra katrorë kemi me i dhanë 1336 metra katrorë. Këtu është e shënuar.

Ernesta Krasniqi: Sa e kuptova prona te cilat banorët kanë ndërtu këto shtëpi nmes rrugës, a krejt janë kry para lufte a?
Kjo rruga që ju po e bëni rrugë publike, kujt po i shërben?

Korab Krasniqi: Kjo rrugë u shërben qytetarëve që banojnë aty. E për me e pa kur është bë ky ndërtim vetëm me ortofoto ne gjeoportal secili mundeni me pa.

Heset Malsiu: Unë mendoj që hapja e rrugës është interes e qytetarëve, por në këtë rast rrugët duhet të hapen edhe në prona private, sexili mundet me e bë në prona të veta. Tjetra, a do të vazhdoj ky sistem kështu.

Korab Krasniqi: Po ju premtoj qe kemi me vazhdu sepse nuk kemi asgjë me fsheh, përndryshe nëse kta kanë vullnet me qel vetë rrugën ne skish pas nevojë me ndërhy fare.

Bashkim Krasniqi: Kjo rrugë është e lëshuar nga vetë banorët e cila nuk po përdoret më, unë mendoj që interesi publik në këtë rast janë vet banorët.

Xhelal Dema: Desha me bë një sqarim, ata kanë apliku për legalizim e përderisa është në pronë komunale shtëpia besoj se ata kan mund edhe vet me bë zgjidhje po shkak i kësaj është desht kshtu.

Ernesta Krasniqi: As rruga aktuale sështë e shtruar, as ajo që do hapet. Neve po na intereson me ditë.

Kjani Zeneli: Unë nuk jam i kënaqur aspak me këto ndërrime, unë këtë nuk e votoj kurrë pa e kuptu mirë.

Selajdin Troni: Ti e ke qu dorën për pjesën tënde atje, ktu është pjesë me ju dhënë qasjë qytetarëve.

Korab Krasniqi: Kjo hapje e rruges i jep qasje edhe 8 pronave të reja. Kemi një mundesi që me ju bë zgjidhje qytetarëve, dhe me ofru mundësi.

Kadrije Lika Troni: Dmth kjo parcela 1490 ka me u këmby dhe nuk po kompenzohet me rrugën, pse spo na tregon për këtë parcelën që ka me ju dhënë edhe ajo?

Korab Krasniqi: Ndoshta më ka ik kty detaj, kjo parcela 164-2, 149-0 janë pronë komunale dhe ndërrohen me këtë tjetrën,

Kadrije Lika Troni: Ska more nevojë komuna me dhënë prona, pse unë nuk i thashë komunës me më ndërru prona për me hap rrugën. Ju mundeni me i dakordu banorët po ska nëvojë për ndërrim prone. Edhe në MAPL kam me dërgu këtë.

Ardita Rrahmani: E kam një pyetje për këta që po e refuzojnë, këtu janë 3 ari, cka mundet me ba komuna me qeto 3 ari? Me 3 ari fushë sportive a? Unë jam për me ju bë zgjidhje qytetarëve.

Brahim Imishti: Unë vec deshta me ju pyet LVV, para kësaj seance e kemi votu një pikë gati të njejtë por për një biznes, aty keni mund me i ra nëpër depo por e keni votu unanimisht.

Selajdin Troni: Atëherë nëse nuk ka edhe dicka e hudhim këtë pikë në votim. 11 për, 2 abstenime, 7 kundër. Prezent 20. Me këtë rast konstatoj se Kuvendi Komunal mori:

VENDIM
Vendim për shpalljen në interes publik të parcelave kadastrale në ZK, Elezaj;

7. Propozim-Vendim paraprak për dhënien e pronës së paluajtëshme të komunës në shfrytëzim afatshkurtër;

Arlinda Rakoci - Ndryshimi vlen vetëm për ndryshimin e numrave të lokaleve në kadastër sepse pas regjistrimit ka ndryshu numrat, vetëm cështje teknike. Nga ky vendim fillon jepja në shfrytëzim të pronave për krijimin e kushteve për bizneset, do jepen gjithsej 18 lokale.

Kadrije Lika Troni - Ndërtimi i këtij objekti ka gilluar në vitin 2016, a ka leje ky ndërtim, cfarë shume është shpenzu për ndërtimin e këtyre lokaleve.

Korab Krasniqi: Punimet kanë fillu 2021, ka leje ndërtimi dhe është në rregull me dokumentacione.

Valdrin Dogani: Në vitin 2022 është nënshkruar vendimi për ndërtim, vlera për këtë projekt ka arrit 320.937 euro.

Kadrije Lika Troni: Ky lokacion përfshin hapsirën nga busti i Idriz Seferit deri tek cajtorja e agës bub. Sipas Planeve Urbane Komunale, PZhU deri 2010-2020 dhe PRrU për zonën e parë dhe të dytë i vlefshëm 2012-2017, mundësi e shfrytëzimit të tij deri në një

dokumentacion tjetër, ky lokacion ka qenë i paraparë për hapsirë publike si brez i gjelbër, ndërtimi i ketij objekti është në kundërshtim me planin urban, ky lokacion është pjesë e planit rregullues urban edhe pasi në këtë plan është caktuar tjetër destim, ky ndërtim është kundëligjor, ne gjithmonë jemi për të u ndihmuar qytetarëve por jo duke vepruar kundërligjshëm, ne sot do ta votojmë këtë por pjesa tjetër e juaja e ndërtimit le të mbetet në përgjegjësinë tuaj.

Korab Krasniqi: Ajo që po e përmendni ju ka qenë e destinuar të jetë shteg por ka pasë nevojë të prishen shumë objekte të tjera por ato objekte unë mëndoj që ja kanë shtu edhe një pjesë edhe hjeshinë dhe të këtë një pjesë të vjetër qyteti jonë dhe të jetë si zgjidhje më e mirë. PZhK nuk është në fuksionim që nga viti 2017. Unë këtu nuk shoh shkelje të ligjit.

Betim Shala: Dua ta sqaroj se nuk e kam lëshu unë këtë leje. Nëse nuk ka plane rregulluese per zonën e parë dhe një pjesë të zonës së dytë sipas. Thuhet se ky plan ka vlefshmeri 5 vite, nuk mundemi me quajt një plan të vlefshëm kur e humb vlefshmërinë e vetes. Po nëse nuk ka plan rregullues atëher vazhdohet me ato.

Kadrije Lika Troni: Nëse ka 5 vite afat, pas sa kohe duhet të shfrytëzohet ai plan.

Betim Shala: PZhK dhe PZhU vazhdojnë edhe pas skadimi por Planet Rregulluese nuk janë të obligueshme. Plani i zhvillim urban në fakt mu nuk është me ligjin e ri për planifikim opsional. Plani i zhvillimor urban vazhdon edhe pas skadimit vazhdon automatikisht. Po planet rregulluese më me ligjin e ri për planifikim hapsimor nuk janë të obligueshme.Janë veç në për zona të cilat komuna e e she të arsyeshme që duhet me u bë plane rregulluese që tash janë të obligueshme plani zhvillimor komunal edhe harta zonale ama nuk është e harta zonale nuk mundet me u bë po u bë plani zhvillimor komunal e plani rregullues. Ti mundesh me bë plan rregullues për një zonë turistike, për një zonë të veçantë të qytetit ose një zonë diku qe sheh.

Kadrije Lika Troni: Qe tash po ta bëj një pyetje ty meqë i përmende hartat zonale se pikërisht unë e kam parë një dokument të nënshkruar prej teje që operatori e kishte nënshkruar për harta zonale edhe pagesa është bërë ndërkohë s'ka harta zonale. A mundesh me na tregu qëta qysh paguhet operator kur s'kena harta zonale?

Betim Shala: Unë nuk i bëj hartat zonale. Duhesh me ditë me kuptuar procesin e kontraktimit po dikuj që ka me bë një projekt se edhe harta zonale, plani rregullues, plani zhvillimor komunal. Po ta shpjegoj kështu prej fillimit edhe ta shpjegoj që tash e kam nënshkruar unë edhe ta shpjegoj pse s'u miratuar. Po edhe pse mu plani zhvillimor komunal i 2010-ës, plani rregullues i 2012-s edhe që harta zonale janë të kontraktuar me palë të jashtme, domethënë me kompani të jashtme. në vitin 2017 kur se ndoshta s'i ke kqyr letrat hiç a krejt se kur t'i kqyrh letrat duhesh me i kqyr letrat krejt jo veç gjysëm në vitin 2017 kur u bë miratimi i kuvendit të komunës për me vazhdu me harta zonale unë nuk jam kanë në punë hiç. Unë jam kthyer në punë meë 2 maj 2017n. Kjo u morrë vendimi më herët. Komuna e ka kontraktu një ekip për me bë hartat zonale e ka kontraktuar një ekipë të jashtme, domethënë një kompani të jashtme të licenscumar. E kompania. Unë kam qenw mbikëqyrës i asaj kontratës ndoshta e ke parë aty që janë që tre at ku e ke parë nënshkrimin kryesues i komisionit ë s'ka kryesues të komisionit janë tu me as të barabarta apo në rregull edhe nëse domethënë kryesues në rregull kompania e ka kryer punën e vetë janë procedurat e urbanizmit mbasandej edhe arsye që sipas meje të arsyeshme pse s'ka vazhduar se s'ka mundur me vazhdu me përpara para me zbatu atë plan me çu në kuvend edhe për me pa atw

cka e kam nwnshkru mundet secili.

Islam Gashi: A është bërë ndonjë analizë nga komuna se cili është w përfitimi financiar nga dhënia janë shfrytëzim i këtyre 18 lokaleve? përafërsisht a u caktuar sa ka me qenë metër katror i qirasë dhe diçka a kanë këto objekte pranim teknik

Arlinda Rakoci Raka: Analizë nuk u bë po normal këto është për biznese kanë me përfituar bizneset por njëkohësisht edhe kanë me bërë pagesën ndaj komunës e qirasë me rregullore është rregullorja për taksa dhe tarifa

Selajdin Troni: Nwse nuk ka dicka pwr diskutim e hedh pikwn nw votim. Me 19 vota pwr asnjw kundwr dhe asnjw abstenim konstatoj se kuvendi komunal mori:

VENDIM
Propozim-Vendim paraprak për dhënien e pronës së paluajtëshme të komunës në shfrytëzim afatshkurtër

8.Propozim-Vendim për Formimin e komisionit të ankesave për procedurën e dhënien në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtëshme të komunës;

Selajdin Troni: Tash e kemi formimin e komisionit te pika e tetë ë. Dy anëtarë shku nga ekzekutivi, një anëtar nga PDK, një nga Vetëvendosja dhe një anëtar nga shoqëria civile. Atëherë kërkoj nga ekzekutivin dy emra për komision. Urdhëro drejtoreshë.
Arlinda Raka: Faleminderit shumë. Ë po komisioni do të ketë këtë përbërje nga ekzekutivi po i jap emrat është Besmir Krasniqi dhe Arxhend Guri.

Bashkim Krasniqi: nga PDK propozojmw Shqipe Murseli.

Ernesta Krasniqi: Nga VV Jeton Luma.

Arlinda Raka: Nga Shoqwria Civile Elmihane Malsiu.

Selajdin Troni: Nwse nuk ka dicka pwr diskutim e hedh pikwn nw votim. Me 15 vota per, 3 abstenime, 1 kunder konstatoj se kuvendi komunal mori:

VENDIM
Vendim për Formimin e komisionit të ankesave për procedurën e dhënien në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtëshme të komunës

9.Propozim-Vendim për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtëshme të komunës.

Arlinda Raka: Komisioni do të ketë këtë përbërje nga ekzekutivi Agron Dema dhe Ardita

Shehu. dhe nga Shoqëria Civile ta japim Emrin Dema.

Bashkim Krasniqi: Partia Demokratie propozon Elona Gjinin.

Ernesta Krasniqi: nga Lëvizja Vetëvendosje Buletin Gurin.

Selajdin Troni: Nwse nuk ka dicka pwr diskutim e hedh pikwn nw votim. Me 16 vota per, 4 kundwr dhe asnjw abstenim, konstatoj se kuvendi komunal mori:

VENDIM

Vendim për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtëshme të komunës

10. Kërkesë nga MAPL për shqyrtimin e vendimit 01Nr.104/02-11476/26 për aprovimin e strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal për Komunën e Kacanikut.

Selajdin Troni: ka ardhë pak më vonë. po besoj që e keni marrë materialin. E keni kërkesë nga MAPL për rishqyrtim. Ja jap fjalwn drejtoreshws pwr sqarime.

Arlinda Raka: pra draft strategjia që është prezantuar me votim në votim ka qenë e rregullt në përmbajtje. Megjithatë MPL ka kërkuar që të gjitha projektet të kenë të përcaktuar koston. Për këtë arsye projektet fillimisht nuk ishin kosto të paraparë pasi realizohen nga stafi i komunës, por janë kostuar tash sipas udhëzimeve të MAPL-së dhe tash kemi marrë edhe një konfirmim nga MAPL-ja se dokumenti është në rregull. Tash ky që po e paraqesim ë pra dhe kërkojmë sërish miratimin dhe procedimin e mëtejmë.

Selajdin Troni: Nwse nuk ka dicka pwr diskutim e hedh pikwn nw votim. Me 11 vota per, 9 kundwr dhe asnjw abstenim, konstatoj se kuvendi komunal mori:

VENDIM

Vendim 01Nr.104/02-11476/26 për aprovimin e strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal për Komunën e Kacanikut.

Mbledhja i përfundoj në ora 13:30.

Procesmbajtës
Arianita Bajrami

Kryesues i Kuvendit
Selajdin Troni

Republika e Kosovës

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAČANIK

	Data 09.09.26	Vendi KAÇANIK
Nj. org.	Numri	Shtojcë
01	104/02-24608	1.

KAÇANIKU

Komuna e Kaçanikut

KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI – KKSB

RAPORT 6-MUJOR I PUNËS
PËR PERIUDHËN JANAR – QERSHOR 2026

I. HYRJE

Ky raport paraqet aktivitetin dhe çështjet kryesore të trajtuara nga Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) i Komunës së Kaçanikut gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026. Raporti është hartuar në bazë të tri procesverbaleve të mbledhjeve të KKSB-së, të mbajtura më 25 shkurt, 28 prill dhe 9 qershor 2026.

Gjatë kësaj periudhe, KKSB ka shërbyer si forum për bashkëpunim dhe koordinim ndërmjet institucioneve komunale, Policisë së Kosovës, FSK-së, institucioneve arsimore, organizatave dhe përfaqësuesve të komunitetit, me qëllim identifikimin dhe adresimin e çështjeve që ndikojnë në sigurinë në bashkësi.

II. MBLEDHJET E MBAJTURA

Gjatë periudhës raportuese janë mbajtur tri mbledhje të KKSB-së:

1. Mbledhja e parë – 25.02.2026;

2. Mbledhja e dytë – 28.04.2026;

3. Mbledhja e tretë – 09.06.2026.

Në mbledhjen e parë u konstatua kuorumi dhe u miratua rendi i ditës. U emërua koordinatori i KKSB-së, z. Gazmend Bunjaku, dhe u diskutua gjendja e sigurisë në komunë. Për janar 2026, Policia raportoi 36 raste, prej të cilave 29 vepra penale dhe 7 raste kundërvajtëse. Ndër rastet e përmendura ishin lëndimi i lehtë trupor, armët, mashtrimi, sulmi, vjedhjet, dëmtimi i pronës, kanosja, narkotikët, dhuna në familje dhe keqtrajtimi i fëmijëve.

Në këtë mbledhje u formua edhe grupi punues për hartimin e Planit Vjetor të Punës së KKSB-së për vitin 2026.

Në mbledhjen e dytë, gjendja e sigurisë u vlerësua përgjithësisht e qetë, ndërsa u trajtuan raste të dhunës në familje, kanosjeve dhe përdorimit të narkotikëve. Vëmendje e veçantë iu kushtua sigurisë në shkolla, dhunës dhe bullizmit, përfshirë bullizmin online, mekanizmave anonimë të raportimit, trajnimit të mësimdhënësve dhe vetëdijesimit të nxënësve e prindërve.

Gjithashtu u diskutua funksionalizimi i kamerave të sigurisë, dëmtimi i objekteve fetare, parkimi dhe bllokimi i trotuareve, si dhe siguria e fëmijëve dhe komunikimi me institucionet sociale.

Në mbledhjen e tretë, situata e sigurisë u vlerësua e qetë dhe pa raste serioze që kanë cenuar sigurinë e qytetarëve. U theksua se Policia kishte angazhim të shtuar për mbarëvajtjen e procesit zgjedhor dhe se rastet kriminale, sipas përfaqësuesit policor, kishin shënuar rënie.

Tema kryesore e kësaj mbledhjeje ishte siguria në trafikun rrugor dhe hapësirat publike. U diskutuan ndriçimi publik, sinjalizimi rrugor, shpejtësia pranë shkollave, parkingu pranë çerdhes, kanalizimi, punimet në Çarshinë e Vjetër, zhurma nga lokalet, përdorimi i trotinetëve nga fëmijët dhe gatishmëria për sezonin veror.

III. VLERËSIMI I GJENDJES SË SIGURISË

Nga diskutimet dhe raportimet e bëra në tri mbledhjet e KKSB-së, gjendja e sigurisë në Komunën e Kaçanikut gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026 është vlerësuar përgjithësisht e qetë dhe e menaxhueshme. Megjithatë, janë evidentuar disa fusha që kërkojnë vëmendje dhe angazhim të vazhdueshëm institucional.

Ndër çështjet kryesore të identifikuara janë: dhuna në familje, përdorimi dhe shpërndarja e narkotikëve, dhuna dhe bullizmi në shkolla, bullizmi online, braktisja e shkollës, siguria në komunikacion, parkimi dhe bllokimi i trotuareve, zhurma gjatë natës, qentë endacakë dhe kapacitetet e Shërbimit të Zjarrfikësve.

IV. SIGURIA NË SHKOLLA DHE MBROJTJA E FËMIJËVE

Siguria në shkolla ka qenë një nga temat më të rëndësishme të trajtuara gjatë periudhës raportuese. KKSB ka theksuar nevojën për bashkëpunim të vazhdueshëm ndërmjet Policisë së Kosovës, Drejtorisë së Arsimit, shkollave, prindërve dhe institucioneve sociale.

Është diskutuar veçanërisht dukuria e bullizmit, përfshirë bullizmin online, si dhe mungesa e raportimit të disa rasteve. Është propozuar krijimi i një mekanizmi anonim të raportimit, formimi i një ekipi ndërinstitucional dhe hartimi i një plani veprimi kundër bullizmit. Po ashtu është kërkuar vazhdimi i trajnimeve për stafin arsimor dhe aktivitetet vetëdijesuese për nxënësit e prindërit.

Në procesverbal është evidentuar edhe shqetësimi për katër raste të braktisjes së shkollës gjatë vitit, duke kërkuar trajtim institucional të tyre.

V. SIGURIA NË TRAFIK DHE HAPËSIRAT PUBLIKE

Në mbledhjen e tretë u trajtuan një numër çështjesh që lidhen drejtpërdrejt me sigurinë në trafikun rrugor dhe hapësirat publike. U ngrit nevoja për përmirësimin e ndriçimit publik dhe sinjalizimit rrugor, si dhe për identifikimin e pikave të rrezikshme.

U paraqit kërkesa për vendosjen e një pengese të shtrirë në rrugën "Vëllezërit Çaka", afër shkollës në fshatin Bob, për shkak të shpejtësisë së automjeteve. Gjithashtu u diskutua gjendja e komunikacionit dhe parkimit pranë çerdhes së fëmijëve, ku është kërkuar rritja e sigurisë për fëmijët dhe prindërit.

U diskutua edhe nevoja për vazhdimin e aktiviteteve parandaluese lidhur me fëmijët që përdorin trotinetë në rrugë dhe hapësira publike.

VI. GATISHMËRIA PËR EMERGJENCA DHE SEZONIN VEROR

KKSB ka trajtuar edhe gatishmërinë e institucioneve të sigurisë për sezonin veror. Policia e Kosovës ka njoftuar se ka përgatitur plan operativ për sezonin veror, ndërsa Shërbimi i Zjarrfikësve ka planin e vet operativ. Është evidentuar nevoja për kapacitete të mjaftueshme njerëzore dhe teknike, veçanërisht për shkak të mungesës së stafit në Shërbimin e Zjarrfikësve.

Në këtë kuadër është vlerësuar e nevojshme që institucionet të vazhdojnë bashkëpunimin dhe koordinimin gjatë periudhave me fluks të shtuar të automjeteve dhe qytetarëve, si dhe në parandalimin dhe menaxhimin e zjarreve.

VII. BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL

Një element i përbashkët i të gjitha mbledhjeve ka qenë rëndësia e bashkëpunimit ndërinstitucional. Në punën e KKSB-së kanë marrë pjesë përfaqësues të Komunës, Policisë së Kosovës, FSK-së, arsimit, HANDIKOS-it, Kryqit të Kuq, bizneseve, komunitetit, Këshillit Lokal për Siguri Publike, Ekipet Veprues për Siguri në Bashkësi.Këshillit të Prindërve, Zyrës për Barazi Gjinore, KBI-së dhe Komitetit për Komunitete.

Ky përfaqësim ka mundësuar që çështjet e sigurisë të trajtohen nga këndvështrime të ndryshme dhe që shqetësimet e qytetarëve të përcillen në forumet institucionale përkatëse.

VIII. REKOMANDIMET KRYESORE

1. Të vazhdohet dhe intensifikohet bashkëpunimi ndërmjet Komunës, Policisë së Kosovës, institucioneve arsimore, prindërve dhe institucioneve sociale.

2. Të vazhdojnë aktivitetet vetëdijesuese dhe ligjëratat në shkolla për parandalimin e dhunës, bullizmit, narkotikëve dhe sjelljeve devijante.

3. Të krijohet një mekanizëm funksional për raportim anonim të bullizmit, dhunës dhe dukurive të tjera negative në shkolla.

4. Të shqyrtohet formimi i një ekipi ndërinstitucional dhe hartimi i planit të veprimit kundër bullizmit, përfshirë bullizmin online.

5. Të vazhdojnë trajnimet për mësimdhënësit dhe aktivitetet vetëdijesuese për nxënësit dhe prindërit.

6. Të vazhdojë funksionalizimi dhe përdorimi i kamerave të sigurisë për rritjen e sigurisë dhe ndihmën në zbardhjen e rasteve.

7. Të përmirësohet ndriçimi publik dhe sinjalizimi rrugor, me prioritet pikat e identifikuara si të rrezikshme.

8. Të shqyrtohet kërkesa për vendosjen e pengesës së shtrirë pranë shkollës në fshatin Bob.

9. Të trajtohet me prioritet siguria dhe parkimi pranë çerdhes së fëmijëve.

10. Të vazhdojë zbatimi i planeve operative për sezonin veror nga Policia dhe Shërbimi i Zjarrfikësve.

11. Të shqyrtohen mundësitë për përmirësimin e kapaciteteve njerëzore dhe teknike të Shërbimit të Zjarrfikësve.

12. Të intensifikohet monitorimi i orarit dhe zhurmës së lokaleve të gastronomisë gjatë natës.

13. Të ndërmerren aktivitete parandaluese për sigurinë e fëmijëve që përdorin trotinetë.

14. Të vazhdohet trajtimi me prioritet i rasteve të dëmtimit të objekteve fetare dhe bashkëpunimi me komunitetin.

15. Të përcillet zbatimi i rekomandimeve të KKSB-së në mbledhjet pasuese dhe të kërkohen informata nga institucionet përgjegjëse për masat e ndërmarra.

IX. PËRFUNDIM

Në përfundim, puna e KKSB-së gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026 ka qenë e orientuar në identifikimin e çështjeve të sigurisë, diskutimin e shqetësimeve të qytetarëve dhe koordinimin e veprimeve ndërmjet institucioneve dhe komunitetit. Nga tri mbledhjet e mbajtura rezulton se gjendja e përgjithshme e sigurisë është vlerësuar e qetë dhe e menaxhueshme, ndërsa vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet parandalimit të dukurive negative, sigurisë në shkolla, trafikut rrugor, hapësirave publike dhe gatishmërisë për emergjenca.

	XI	139	56	83	136	54	82	48	11	37	44	13	31	25	16	9	6	3	3	123	43	80	90.44	2	1	1	1	1	0	0	-3	0	3	2	1	3	2	1	3	2	1	3.88%
	XII	167	55	112	163	53	110	58	10	48	47	11	36	49	25	24	8	6	2	162	52	110	99.39	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	4	2	2	4	2	2	3.91%
	X-XII	481	182	299	467	176	291	162	34	128	131	38	93	106	57	49	17	12	5	416	141	275	89.08	24	12	12	14	11	3	2	-38	0	40	25	15	14	6	8	14	6	8	3.84%
IAAP "feriz Guri dhe v	X	166	130	36	137	105	32	4	3	1	16	8	8	75	57	18	35	30	5	130	98	32	94%	1	1	0	0	0	0	4	4	0	5	5	0	31	27	4	0	0	0	2.80%
	XI	114	89	25	107	83	24	3	2	1	15	12	3	51	40	11	31	24	7	105	82	23	98%	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	9	7	2	0	0	0	2.77%
	XII	113	91	22	113	91	22	5	3	2	30	20	10	56	48	8	21	19	2	113	91	22	100%	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	3.10%
	X-XII	393	310	83	357	279	78	12	8	4	61	40	21	182	145	37	87	73	14	348	271	77	97.30%	1	1	0	0	0	0	4	4	0	5	5	0	40	36	6	0	0	0	2.89%
Gjithsej		874	492	382	824	455	369	174	42	132	192	78	114	288	202	86	104	85	19	764	412	352	92.7184	25	13	12	14	11	3	6	-34	0	45	30	15	54	42	14	14	6	8	3.365

8.2 Kuadri arsimor, mungesat e nxënësve dhe orët e pambajtura të mësimdhënësve në nivelin e mesëm të lartë

Në fillim të vitit shkollor në dy shkollat e këtij niveli janë angazhuar gjithsej 89 mësimdhënës, prej tyre 43 femra dhe atë 41 në Gjimnazin "Skënderbeu" e 48 në IAAP "Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka" me kualifikueshmëri 100 % .
Një segment mjaft i rëndësishëm është edhe vijimi i rregullt i nxënësve e mësimdhënësve, ndërkaq janë bërë përpjekje maksimale për uljen në minimum të mungesave të tyre.
Në fund të këtij viti shkollor nxënësit e këtij nivelit të AML-së kanë bërë gjithsejt 59199 mungesa, prej të cilave 42544 të arsyeshme ose 72.52 për kokë nxënësi.
Edhe numri i orëve të humbura nga mësimdhënësit është relativisht i lartë, ndërkaq kërkohet që të merren masa me qëllim të zvogëlimit në minimum të numrit të orëve të humbura mësimore. Mësimdhënësit e këtij niveli kanë humbur gjithsej 1189 orë mësimi apo 13.57 orë mësimi për një mësimdhënës.
Kualifikimi dhe ngritja profesionale, qasja e bazuar në kompetenca dhe rezultate është kusht elementar dhe kyq për realizimin e suksesshëm të plan-programit mësimor dhe njëkohësisht është faktor relevant për mësimdhënie e nxënie kualitative, dhe sigurim të cilësisë, andaj edhe këtë vit shkollor i është kushtuar vëmendje e veçantë ngritjes dhe sigurimit të cilësisë.

Për më shumë informata shih **Tabelën Nr.6**
Kuadri arsimor, mungesat e nxënësve dhe orët e humbura të arsimtarëve në shkollat e mesme në gjysmëvjetorin e dytë të vitit shkollor 2025/2026

Nr.	Emri i shkollës	Kuadri Arsimor					Mungesat e nxënësve		Mesatarja për nxënës	Orët e humbura të arsimtarëve	Mesatarja për arsimtarë
		Gj	M	F	Kualifikuar	%	Gj	Arsyeshme			
1	"Skënderbeu"	41	19	22	41	100%	28759	21771	59.79	667	16.27
2	IAAP "F. Guri dhe v. Çaka"	48	27	21	48	100%	30440	20773	85.26	522	10.87
3	Gjithsej	**89**	**46**	**43**	**89**	**100%**	**59199**	**42544**	**72.525**	**1189**	**13.57**

Tabela Nr. 7
Regjistrimi (shtator 2025) kundrejt suksesit të gjysmëvjetorit të dytë (qershor 2026) viti shkollor 2025/2026


Komuna e Kaçanik

SMIA / MASHTI


Regjistrimi (shtator 2025) kundrejt suksesit të gjysmëvjetorit të dytë (qershor 2026) • Viti shkollor 2025/26

4.471	4.456	15	0,3%	94,1%
Regjistrim	Sukses GJV2	Diferenca	Diferenca %	Kalueshmëria

Regjistrim kundrejt suksesit



Struktura e suksesit



Krahasimi gjinor


	Meshkuj	Femra
Nxënës	2.335	2.121
Kalueshmëria	91,2%	97,4%
Shkëlqyeshëm	28,3%	54,1%

Struktura e detajuar

Shkëlqyeshëm	1.808	40,6%
Sh. mirë	975	21,9%
Mirë	1.028	23,1%
Mjaftueshëm	384	8,6%
Të pa notuar	66	1,5%
Me një notë të dobët	115	2,6%
Me dy nota të dobëta	70	1,6%
Kanë përsëritur klasën	5	0,1%
Me tri e më shumë nota t...	5	0,1%
Përcillen me nota negati...	0	0,0%

Diferenca brenda kufijve të pritur.

Kalueshmëria sipas klasave (%)



Burimi: Sistemi për Menaxhimin e Informatave në Arsim (SMIA) • MASHTI • Divizioni për Administrimin e Platformave Digjitale në Arsim

Duke u bazuar në të dhënat e sistemit SMIA (Sistemi për Menaxhimin e Informatave në Arsim), në fillim të vitit shkollor 2025/2026 (shtator) kanë qenë të regjistruar 4471 nxënës, ndërsa vitin shkollor me sukses pozitiv e kanë përfunduar 4456 nxënës, dallimi është 15 nxënës më pak (0.3%), kalueshmëria është 94.1%, prej tyre 2335 meshkuj (91.2%) dhe 2121 femra (97.4%).
Struktura e suksesit:

- Shkëlqyeshëm 40.6%
- Shumë mirë 21.9%
- Mirë 23.1%
- Mjaftueshëm 8.6%
- Me nota të dobëta 4.3%.

Kalueshmëria sipas klasave:

- Klasa e parë 99%
- Klasa e dytë 100%
- Klasa e tretë 100%
- Klasa e katërt 100%
- Klasa e pestë 99%
- Klasa e gjashtë 93%
- Klasa e shtatë 87%
- Klasa e tetë 88%
- Klasa e nëntë 97%
- Klasa e dhjetë 77%
- Klasa e njëmbëdhjetë 90% dhe
- Klasa e dymbëdhjetë 98%.

9. Provimi i Maturës dhe Testi i Arritshmërisë

Sikurse edhe viteve të mëhershme, edhe këtë vit, testit të maturës i janë nënshtruar nxënësit maturantë të 2 shkollave të mesme, ndërsa në test janë përfshirë tri lëndë të obliguara (Gjuhë shqipe, Gjuhë angleze dhe Matematikë) dhe një lëndë zgjedhore (që është zgjedhur nga vet nxënësit) nga lëndët zgjedhore në dispozicion, me gjithsej 100 pikë, nga secila lëndë me nga 25 pikë të mundshme.

Në afatin e parë të qershorit, të mbajtur më 20 qershor 2026, provimit të maturës iu janë nënshtruar gjithsej 230 nxënës maturantë prej tyre 168 nxënës në Gjimnazin "Skënderbeu" dhe 62 të tjerë të IAAP "Feriz Guri dhe vëllezërit Çaka", ndërsa atë e kanë kaluar 150 nxënës apo 65.2%.
Në Gjimnazin "Skënderbeu" nga gjithsej 168 maturant, sa i janë nënshtruar testit të maturës, atë e kanë kaluar gjithsej 125 prej tyre, apo 74%, ndërsa 43 maturantë nuk kanë arritur pikët e mjaftueshme. Ndërkaq, në IAAP "Feriz Guri e vëllezërit Çaka", nga 62 nxënës maturant që iu janë nënshtraur provimit të maturës 25 prej tyre e kanë kaluar apo 41.6%, e 37 prej tyre nuk kanë fituar pikët e mjaftueshme apo nuk kanë arritur të kalojnë pragun prej 40% nga 100 pikë të mundshme. (Gjimnazi 114 nxënëse femra, ndërsa testin e kaluan 86 prej tyre, ndërsa në IAAP 14 nxënëse femra, ndërsa testin e kanë kaluar 5 prej tyre. Nga të dy shkollat e mesme të larta, testin e maturës e kanë kaluar 91 nxënëse femra apo 46.1%).
Këtë vit kalueshmëria në nivel Komune shpehur në përqindje është 65.2%

Në Afatin e Gushtit të mbajtur më 29 Gusht në Testin e Maturës kanë hyrë gjithsej 64 nxënës, ndërsa atë e kanë kaluar gjithsej 35 apo 54,69 %. Në Gjimnazin "Skënderbeu" kanë hyrë 40 nxënës, ndërsa e kanë kaluar 27 prej tyre apo 67.50 % dhe 24 nga shkolla profesionale prej të cilëve e kanë kaluar 11 apo 45.83 %.

Gjatë këtij viti shkollor, në dy shkollat e mesme, kanë qenë të regjistruar gjithsej 341 nxënës maturant, ndërkaq mësimet i kanë vijuar 305 maturant, prej tyre 168 në Gjimnazin "Skënderbeu" dhe 137 në IAAP "Feriz Guri dhe vëllezërit Çaka".

Ndërkohë, 416 nxënës semimaturantë e kanë mbajtur Testin e Arritshmërisë më 26 Qershor në vetëm një herë dhe me gjithsej 100 pikë/kërkesa, për dallim nga vitet e mëhershme kur testi mbahej në dy pjesë dhe me gjithsej 200 pikë/kërkesa të mundshme. Testi është mbajtur për lëndët: Gjuhë amëtare (20 pikë/kërkesa), Gjuhë angleze (5 pikë/kërkesa), Histori (13 kërkesa/pikë) dhe Gjeografi (12 pikë/kërkesa), Matematikë (20 pikë/kërkesa), Informatikë (5 pikë/kërkesa), Fizikë (8 pikë/kërkesa), Kimi (8 pikë/kërkesa) dhe Biologji (9 pikë/kërkesa). Nga rezultatet e arritura, nxënësit semimaturantë të SHFMU "Gafurr Luma" në Gllobočicë janë radhitur në vendin e parë me

48.40% të pikëve të fituara, ata të SHFMU "Emin Duraku" nga Kaçaniku me 46,56% janë radhitur në vendin e dytë dhe ata të SHFMU "Dituria" nga Ivaja janë radhitur në vendin e tretë me 44,85%, etj; ndërsa në nivel të shkollave të Komunës përqindja e kalueshmërisë është **41.10%**

Testi i Arritshmërisë ka për qëllim që t'i orientoj nxënësit në shkollimin e mëtejmë në bazë të numrit të pikëve të fituara dhe arritja e rezultateve sa më të mira.

Kalueshmëria në përqindje dhe renditja e shkollave (nga viti 2016 e deri më 2026) është paraqitur në Tabelën Nr. 5

Nr.	Emri i shkollës	2016%	Renditja	2017%	Rend	2018%	Rend	2019%	Rend	2020	2021%	Rend	2022%	Rend	2023%	Rend	2024%	Rend	2025%	Rend	2026%	Rend
1	Emin Duraku	60.08	4	51,59	2	58,69	2	56,37	2		52.04	2	49.74	3	45.67	7	49.12	1	49.24	1	46.56%	2
2	Idriz Seferi	50.64	10	42,07	8	49,74	9	49.25	5		50.44	4	51.25	1	49.57	5	47.59	3	45.83	6	38.16%	9
3	Kadri Zeka	58,57	6	38,93	10	57,82	3	38.75	10		50.81	3	40.58	8	52.14	2	44.79	5	46.96	4	35.44%	11
4	Jusuf Gërvalla	59,48	5	46,72	3	56,28	4	51.43	4		47.3	6	43.14	6	53.84	1	44.08	7	47.73	2	40.66%	7
5	Nazmi Osmani	47,03	11	45,53	5	52,73	6	48.75	6		43.46	8	39.93	10	43.39	9	38.29	10	39.82	8	37%	10
6	Qamil Ilazi	53,30	9	52,18	1	52,09	7	53.58	3		58.8	1	50.73	2	46.74	6	42.96	8	46	5	44.70%	4
7	Ali Asllani	54,34	8	45,84	4	39,13	12	44.11	7		40.67	9	44.91	5	44.86	8	48.02	2	47.33	3	41.75%	5
8	7 Shtatori	64.25	1	54,31	6	40,07	10	38.67	11		39.64	10	40.09	9	50.12	3	44.36	6	35.03	10	40.10%	8
9	Gafurr Luma	57,93	7	35,13	12	39.48	11	33.3	12	Pandemi	33.26	11	36.19	11	43.38	10	46.03	4	40.37	7	48.40%	1
10	Agim Bajrami	60,55	3	39,90	9	50,54	8	59.11	1		46.92	7	42.39	7	49.6	4	40.36	9	38.15	9	34.14%	12
11	Dituria	42,39	12	37,94	11	54,92	5	40	9		48.5	5	36.15	12	41	11	34.66	11	34.25	11	44.85%	3
12	Kater Deshmoret	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A		N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	41.45%	6
13	**Mesatarja e shkolles**	**56,38 %**		**46,37%**		**52,70 %**		**49.84%**			**47.96%**		**43.48%**		**47.24%**		**43.66%**		**45.63%**		**41.10%**	

Vërejtje: Testi i Arritshmërisë nuk është mbajtur në vitin 2020 për shkak të Pandemisë COVID 19.

Një garë mjaftë e rëndësishme ndërshtetërore Shqipëri – Kosovë është shënuar edhe sivjet në Prishtinë, më 23 maj 2026, është mbajtur Olimpiada Shqipëri – Kosovë e Gjuhës Shqipe për klasat e nënta, ndërsa tre nxënës nga shkollat e Komunës sonë ishin kualifikuar (Eda Mulaku, SHFMU "Qamil Ilazi" nga Kaçaniku i vjetër, Unesa Palloshi, SHFMU "Jusuf Gërvalla – Biçec dhe Huvejda Dema, SHFMU "Idriz Seferi" Bob). Nxënësja Eda Mulaku, në një konkurrencë mjaft të fortë, arrin të renditet në vendin e tretë që është një sukses i jashtëzakonshëm dhe nderë e respekt për sistemin arsimor në Komunën e Kaçanikut. Ndërkohë që paraprakisht, më 25 prill ishin mbajtur garat kualifikuese në nivel të Komunës e më 09 maj në nivel të vendit.

Drejtori i Drejtorisë së Arsimit

z. Gazmend Bunjaku

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

Drejtoria e Arsimit
04 Nr 610/01-25433/26

LISTË DISTRIBUIMI/ CIRKULARNO PISMO/ ROUTING SLIP

REFERENCË:					
PËR/ZA/TO:		**Anëtarët e Kuvendit të Komunës**			
NGA/OD/FROM:		**z. Gazmend Bunjaku, drejtor i DKA-së**			
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:		**Informatë - Fillimi i vitit të ri shkollor 2026-27 në Komunën e Kaçanikut**			
Nr. i zyrës: **Br. kancelarije:** **Room No.:**	-	**Lokacioni:** **Kucni:** **Extension:**	**Administrata Komunale**	**Data:** **Datum:** **Date:**	**18.09.2026**

I N F O R M A T Ë

Fillimi i Vitit të Ri shkollor 2026 - 2027

Viti i ri shkollor 2026 – 2027, në Komunën e Kaçanikut ka filluar në të gjitha institucionet arsimore, më 1 shtator 2026, sipas kalendarit shkollor të hartuar nga MASH.

Drejtoria e Arsimit, edhe sivjet i ka filluar me kohë përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor 2026/27. Fillimisht është bërë planifikimi i regjistrimit të fëmijëve para fillor e atyre në klasat e para. Bazuar në raportet e këtij fillim viti shkollor, sivjet janë regjistruar gjithsej 335 fëmijë para fillor, prej tyre 307 në shkollat fillore, ndërsa 28 të tjerë në QEAP "Agimi" në Kaçanik, apo 23 më pak krahasuar me vitin e kaluar (352 fëmijë), ndërkaq në klasat e para këtë vit shkollor janë regjistruar 362 nxënës.

Planifikimi i regjistrimit të nxënësve është bërë edhe në klasat e X-ta, në 2 shkollat e mesme: në Gjimnazin "Skënderbeu" dhe IAAP "Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka". Në Gjimnazin "Skënderbeu" sivjet në klasat e dhjeta janë regjistruar 141 nxënës, ndërsa ishin planifikuar të regjistrohen 182 nxënës të ndarë në 2 drejtime me 7 paralele:

1. **Drejtimi Shkenca Natyrore,** 4 paralele me 89 nxënës të regjistruar
2. **Drejtimi Shkenca Shoqërore-Gjuhësore,** 3 paralele me 52 nxënës.

Ndërkaq, në IAAP "Feriz Guri dhe vëllezërit Çaka" në klasat e dhjeta janë regjistruar gjithsej 146 nxënës, ndërsa kanë qenë të planifikuar të regjistrohen gjithsej 184 nxënës në 9 paralele të ndarë në 3 Drejtimet:

1. **Teknologji e informacionit dhe komunikimit:**
   1.1 Informatikë, me 1 paralele me 24 nxënës

2. **Ekonomi dhe Juridik me profilet:**
   2.1 Tregti me shumicë dhe pakicë (DUAL), 1 paralele me 16 nxënës.
   2.2 Asistent Juridik, 1 paralele me 24 nxënës.

3. **Makineri, prodhim, ndërtimtari dhe Elektroteknikë, me profilet:**
   3.1 Instalues i ngrohjes, klimatizimit, ujësjellësit e kanalizimit, 2 paralele me 35 nxënës të regjistruar nga 48sa ishin të planifikuar
   3.2 Automekanik (DUAL), 1 paralele me 12 nxënës
   3.3 Metalpunues (DUAL), 1 paralele me 16 të planifikuar, janë pranuar 21 nxënës
   3.4 Trafik rrugor, 1 paralele me 24 të planifikuar, janë pranuar 10 nxënës
   3.5 Instalues elektrik (DUAL), 1 paralele me 16 nxënës
   3.6 Tregti me pakicë dhe shumicë (DUAL), 1 paralele me 16 nxënës
   3.7 Asistent juridik 1 paralele, të planifikuar 24, ndërsa janë pranuar 15 nxënës
   3.8 Informatikë 1 paralele, të planifikuar 24 nxënës dhe të pranuar 21 nxënës.

Edhe këtë vit në IAAP "Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka" planifikohet të zhvillohet MËSIMI DUAL në 4 paralele, Tregti me shumicë dhe pakicë-1 paralele, Automekanik-1 paralele, Metal Punues 1 paralele dhe Instalues Elektrik-1 paralele, me mësim Dual që nënkupton një sistem i kombinuar i lëndës mësimore në shkollë me aftësimin profesional e praktikë, ndërkaq në nivel vendi ky lloj mësimi i kombinuar kishte filluar në disa shkolla të vendit në vitin shkollore 2023 – 2024.

Sa i përket kuadrit arsimor, DKA gjithashtu me kohë e ka publikuar konkursin për plotësimin e vendeve të lira, ndërkohë që janë zhvilluar të gjitha procedurat e rekrutimit dhe selektimit për pozitat e lira: 2 mësimdhënës të mësimit klasor (një në SHFMU "Emin Duraku" në Kaçanik, një në SHFMU "Gafurr Luma" në Gllobočicë), një mësimdhënës të lëndës së Matematikës në SHFMU "Kadri Zeka" në Dubravë, tre mësimdhënës të Fizikës, (në SHFMU "Kadri Zeka" në Dubravëë, SHFMU "Nazmi Osmani" Elezaj dhe SHFMU "Qamil Ilazi" Kaçanik i vjetër), një mësimdhënës i lëndës së Muzikës në SHFMU "Nazmi Osmani" Elezaj, një mësimdhënës të lëndës Histori në SHFMU "Emin Duraku" në Kaçanik, një mësimdhënës të lëndës Gjeografi në SHFMU "Emin Duraku" në Kaçanik, një mësimdhënës të lëndës Gjuhë Shqipe në SHFMU "Kadri Zeka" në Dubravë, dy Punëtorë Teknik, (një në SHFMU "Idriz Seferi" Bob dhe QEAP "Agimi" çerdhja e re), një Gjellëbërëse, dy Edukatore, dy Motra Edukatore në QEAP "Agimi" Kaçanik dhe katër Asistent/e për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta arsimore.

Këtë vit shkollor, mësimi ka filluar në 21 institucione shkollore të nivelit AF (Arsimi Fillor) dhe AMU (Arsimi i Mesëm i Ulët), prej tyre 17 shkolla të plota 1 - 9 dhe 4 të tjera ku mësimi zhvillohet për klasat 1-5 ndërkaq, në 1 shkollë mësimi zhvillohet vetëm për klasat 1-4.

Me mjete buxhetore të Komunës janë blerë 50 tabela digjitale në vlerë 56 mijë euro (mjete këto të siguruara nga buxheti i Komunës) për nevojat e shkollave fillore të mesme të ulëta e të mesme të larta, të cilat janë shpërndarë në shkolla para fillimit të vitit të ri shkollor 2026-2027 e të cilat do ta lehtësojnë mësimdhënien dhe mësimnxënien. Është nënshkruar kontrata për mirëmbajtjen, rregullimin dhe ndërrimin e kamerave të sigurisë në shkolla në vlerë 5600 euro, në SHFMU "Emin Duraku" Dushkajë, është bërë lyerja dhe suvatimi i mureve të brendshme në vlerë 2749 euro, në SHFMU "Jusuf Gërvalla" Biqec janë rregulluar toaletet, në vlerë 8300 euro, montimi i klimave në SHFMU "Idriz Seferi" Bob, SHFMU "Kadri Zeka" Dubravë dhe IAAP "Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka" në vlerë 4210 euro, në IAAP "Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka" është bërë ndarja e disa klasave në vlerë 10750 euro dhe së shpejti pritet të fillojnë punimet në ndërtimin e sallës së Edukatës Fizike në SHFMU "Kadri Zeka" në Dubravë në vlerë 419,999,73 euro (projekt dy vjeçar). Vlenë të përmendet se DKA në bashkëpunim me OJQ "Vatra" me seli në Berlin, ka siguruar donacion për krijimin e mini bibliotekave me rreth 200 tituj të librave për klasat 1-9 në tri shkolla fillore e të mesme të ulëta, në SHFMU "Emin Duraku" Kaçanik, SHFMU "Kadri Zeka" Dubravë dhe SHFMU "Jusuf Gërvalla" Biqec, e të cilat kanë për qëllim të nxisin dhe krijojnë kulturën e të lexuarit te nxënësit.
Këtë vit shkollor dy shkolla, SHFMU "Nazmi Osmani" Elezaj dhe IAAP "Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka" e kanë filluar mësimin me vetëm një ndërrim mësimor. Kanë filluar procedurat për mbylljen e SHFMU "Dituria" Ivajë, ku me kohë është bërë planifikimi për sistemimin e nxënësve, mësimdhënësve, dokumentacionit, inventarit dhe personelit tjetër arsimor.
Bazuar në çmimet e përcaktuara në katalog, MASH ka nxjerrë vendimin për vlerën e subvencionimit për secilën klasë. Vlera e subvencionimit për prind/nxënës për tekstet shkollore sipas klasave është si në vijim:

Klasat 1 dhe 2 – 60 euro;

Klasa 3 – 65 euro;

Klasa 4 – 70 euro;

Klasa 5 – 80 euro;

Klasat 6 dhe 7 – 90 euro dhe

Klasat 8 dhe 9 – 100 euro.

Furnizimi i nxënësve me libra ka qenë një nga sfidat e këtij fillim viti shkollor, sikurse që ishte edhe vitin e kaluar. Vlen të theksohet se ka raste kur prindërit për shkaqe të ndryshme nuk kanë arritur të aplikojnë në sistemin e-Kosova, andaj edhe fëmijët e tyre kanë ngelur pa tekste shkollore, por ka edhe shumë raste ku për shkaqe të panjohura akoma nuk është bërë pagesa respektivisht subvencionimi i librave për nxënës.
Në Komunën e Kaçanikut nuk ka asnjë librari, kështu që prindërit dhe nxënësit janë detyruar të gjejnë alternativa për furnizim në qytetet tjera e madje edhe në një shitore ushqimore/minimarket, këtu brenda qytetit të Kaçanikut e cila po merret edhe me furnizimin e nxënësve me libra.

Numri i nxënësve në vitin shkollor 2026 – 2027

Në bazë të dhënave, në shkollat e Komunës sonë kemi këtë gjendje statistikore:
Në nivelin 0 (para fillor) sivjet janë regjistruar gjithsej 335 fëmijë apo 23 më pak, krahasuar me një vit më parë që ishin 352, prej tyre 307 në shkollat fillore e të mesme të ulëta dhe 28 të tjerë të përfshirë në QEAP "Agimi". Në QEAP "Agimi" në të dy objektet në Kaçanik dhe në objektin e ri në Rekë, do të vijojnë/qëndrojnë 181 fëmijë të tjerë që nga grup mosha prej 9 muajsh e deri te grup mosha 4 – 5 vjeç.

Numri i fëmijëve para fillor sipas shkollave

Shkolla	E.Duraku	I.Seferi	K.Zeka	J.Gërvalla	Q.Ilazi	N.Osmani	A.Asllani	7 Shtatori	Dituria	A.Bajrami	G.Luma	K. Dëshmorët	QEAP "Agimi"	Gjithsej
Nr.	79	25	30	32	27	30	17	26	0	14	14	13	28	**335**

Tabela 1. Numri i nxënësve nga klasa I deri V sipas shkollave

Shkolla	I	II	III	IV	V	Gjithsej
"Emin Duraku"	100	103	120	127	153	603
"Idriz Seferi"	30	24	26	33	34	147
"Kadri Zeka"	43	39	35	47	32	196
"Jusuf Gërvalla"	37	31	24	40	34	166
"Qamil Ilazi"	29	31	43	57	48	208
"Nazmi Osmani"	24	18	28	32	43	145
"Ali Asllani"	25	16	24	20	24	109
"7 Shatori"	33	28	20	22	25	128
"Dituria"	0	2	5	2	1	10
"Agim Bajrami"	19	15	18	23	13	88
"Gafurr Luma"	5	10	6	9	5	35
"Katër Dëshmorët"	17	22	10	19	15	83
Gjithsej	**362**	**339**	**359**	**431**	**427**	**1918**

Në nivelin 1 (fillor), gjatë këtij viti shkollor mësimet janë duke i vijuar gjithsej 1918 nxënës, që krahasuar me një vit më parë (1996 nxënës), del se sivjet në këtë nivel janë duke vijuar 78 nxënës më pak.

Tabela 2. Numri i nxënësve nga klasa VI deri IX sipas shkollave

Shkolla	VI	VII	VIII	IX	Gjithsej
"Emin Duraku"	117	139	135	137	528
"Idriz Seferi"	32	33	27	37	129
"Kadri Zeka"	39	44	40	46	169
"Jusuf Gërvalla"	29	33	37	33	132
"Qamil Ilazi"	24	40	40	51	155
"Nazmi Osmani"	25	26	32	37	120
"Ali Asllani"	32	20	34	24	110
"7 Shatori"	26	23	22	32	103
"Dituria"	1	1	0	1	3
"Agim Bajrami"	18	20	18	17	73
"Gafurr Luma"	9	10	14	9	42
"Katër Dëshmorët"	17	20	20	12	69
Gjithsej	369	409	419	436	1633

Ndërkaq, në nivelin 2 (Mesëm të Ulët) nga klasa e VI deri në klasën e IX, mësimet sivjet i kanë filluar gjithsej 1633 nxënës apo 44 më pak, krahasuar me vitin e kaluar shkollor 2025/2026 që në këtë nivel ishin gjithsej 1677 nxënës.

Tabela 3. Numri i nxënësve nga klasa I deri IX sipas shkollave

Shkolla	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	Gjithsej
"Emin Duraku"	100	103	120	127	153	117	139	135	137	1131
"Idriz Seferi"	30	24	26	33	34	32	33	27	37	276
"Kadri Zeka "	43	39	35	47	32	39	44	40	46	365
"Jusuf Gërvalla"	37	31	24	40	34	29	33	37	33	298
"Qamil Ilazi"	29	31	43	57	48	24	40	40	51	363
"Nazmi Osmani"	24	18	28	32	43	25	26	32	37	265
"Ali Asllani"	25	16	24	20	24	32	20	34	24	219
"7 Shatori"	33	28	20	22	25	26	23	22	32	231
"Dituria"	0	2	5	2	1	1	1	0	1	13
Katër Dëshmorët	17	22	10	19	15	17	20	20	12	152
"Agim Bajrami"	19	15	18	23	13	18	20	18	17	161
"Gafurr Luma"	5	10	6	9	5	9	10	14	9	77
Gjithsej	362	339	359	431	427	369	409	419	436	3551

Nga kjo që u tha më lartë, del se numri i përgjithshëm i nxënësve në të dy nivelet (1 dhe 2) fillor dhe të mesëm të ultë në këtë fillim viti shkollor është 3551 ose 122 më pak, përderisa vitin e kaluar në këto dy nivele ishin 3673.

Në tabelën Nr.3 shihet se numri i përgjithshëm i nxënësve në këtë vit shkollor, 2026 - 2027 është 3551 nxënës që krahasuar me vitin shkollor paraprak 2025-2026 ku ishin 3673 nxënës, ky numër është më i vogël për 122 nxënës.

Numri i përgjithshëm i nxënësve të regjistruar sipas viteve, përkatësisht rënia e numrit të tyre është prezantuar në Tabelën e mëposhtme.

Tabela 4. Numri i nxënësve të regjistruar nga I – IX sipas viteve

Viti shkollor	Numri i nxënësve I - IX	Më pak krahasuar me një vit më parë	Më shumë krahasuar me 1 vit më parë
2026-2027	3551	122	
2025 - 2026	3673	234	
2024 2025	3907	183	
2023 - 2024	4090	29	
2022 - 2023	4119	66	
2021 - 2022	4185	133	
2020 - 2021	4318	148	
2019 - 2020	4466	51	
2018 - 2019	4527	100	
2017 - 2018	4627	167	
2016 - 2017	4794	E tjera	

Tabela 5. Numri i nxënësve të regjistruar në dy shkollat e mesme sipas viteve

Viti shkollor	Numri i nxënësve X, IX dhe XII	Më pak krahasuar me një vit më parë	Më shumë krahasuar me një vit më parë
2026-2027	901		57
2025 - 2026	844	75	
2024 - 2025	919	46	
2023 - 2024	965	6	
2022 - 2023	971	53	
2021 - 2022	1024	133	
2020 - 2021	1157	101	
2019 - 2020	1258	216	
2018 - 2019	1474	59	
2017 - 2018	1533	34	
2016 - 2017	1567	E tjera	

Në nivelin 3 (Mesëm të Lartë) në 2 shkollat e mesme, në Gjimnazin "Skënderbeu" dhe IAAP "Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka" këtë vit shkollor 2026-2027 mësimet i vijojnë gjithsej 901 nxënës që krahasuar me një vit më parë (844 nxënës), sivjet ky numër është më i madh për 57 nxënës.

Tabela 6. Numri i nxënësve sipas klasave në 2 shkollat e mesme

Shkolla	X	XI	XII	Gjithsej
Gjimnazi "Skënderbeu"	153	158	135	446
IAAP "Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka"	146	159	150	455
Gjithsej	299	317	285	901

Në Gjimnazin "Skënderbeu" numri i përgjithshëm i nxënësve të regjistruar këtë vit shkollor është 446 (vitin e kaluar 461) ose 15 më pak dhe në IAAP "Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka" sivjet janë regjistruar 445, (vitin e kaluar ishin 414 nxënës) apo 31 më shumë se vitin e kaluar.

Me respekt!

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik/Municipality of Kaçanik
Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim

KAÇANIKU

REFERENCË:	01-561/02 - 20607 /26
DATË:	06.08.2026
PËR/ZA/TO:	Kryesuesin e Kuvendit Komunal- Z. Selajdin Troni; Sekretarinë e Kuvendit
CC:	Kryetari i Komunës- Z. Sabedin Vishi
NGA/OD/FROM:	Festim Neziraj- UD i Shefit të Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për futje në rend dite për shqyrtim dhe miratim të Planit Komunal për ri-integrimin e Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve në Komunën e Kaçanikut 2026-2028

Të nderuar/a,

Në cilësinë e njësisë përgjegjëse për hartimin dhe koordinimin e Planit Komunal për Riintegrimin e Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve në Komunën e Kaçanikut 2026–2028, ju drejtohem me këtë kërkesë për procedimin e këtij dokumenti në rendin e ditës të mbledhjes së radhës së Kuvendit të Komunës së Kaçanikut.

Ju njoftoj se gjatë hartimit të këtij dokumenti janë përmbushur të gjitha procedurat dhe kërkesat e përcaktuara me legjislacionin në fuqi, përfshirë: hartimin e draft-planit nga grupi përgjegjës në bashkëpunim me MPB-në, zhvillimin e procesit të konsultimit publik në përputhje me legjislacionin për transparencë dhe pjesëmarrje të publikut, shqyrtimin e komenteve dhe rekomandimeve të pranuara gjatë konsultimit publik dhe finalizimin e dokumentit për procedim në Kuvendin Komunal.

Ky plan strategjik paraqet dokumentin bazë të Komunës së Kaçanikut për planifikimin dhe koordinimin e masave që synojnë riintegrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve për periudhën 2026–2028, në përputhje me legjislacionin e Republikës së Kosovës dhe politikat shtetërore në këtë fushë.

Duke qenë se janë përmbushur të gjitha hapat proceduralë dhe ligjorë për miratimin e tij, kërkojmë që Plani Komunal për Riintegrimin e Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve në Komunën e Kaçanikut 2026–2028 të futet në rend të ditës të mbledhjes së ardhshme të Kuvendit Komunal për shqyrtim dhe miratim.

Me respekt,

Adresa: Rr. "Qamil Ilazi" Nr. 28, 71000 Kaçanik; Tel. 038 200-46400

Komuna Kaçanik
Opština Kacanik

PLANI KOMUNAL PËR RI INTEGRIMIN E QËNDRUESHËM TË PERSONAVE TË RIATDHESUAR DHE INTEGRIMIN E TË HUAJVE NË KOMUNËN E KAÇANIKUT
2026-2028

Duke u bazuar në nenin ..... të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale,
në harmoni Strategjinë për Migrim 2021 - 2025 të aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, Rregulloren (QRK) Nr.22/2020 Për Riintegrimin e personave të Riatdhesuar si dhe bazuar në Rregulloren për Integrimin e të Huajve (Rregullore (QRK) Nr. 09/2019 për integrimin e të huajve është miratuar në mbledhjen e 110 te Qeverise së Kosovës, me vendimin nr. 01/110, date 11.07.2019) nenin .....të statutit të Komunës së Kaçanikut, Kuvendi i Komunës së Kaçanikut në mbledhjen e Mbajtur më _____ 2026, aprovoi:

Planin Komunal për Ri integrimin e Qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe Integrimit të të huajve në Komunën Kaçanik 2026-2028

Shkurtesat

ANP	Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës
APRK	Agjensioni i Punësimit i Republikës së Kosovës
AZHBR	Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural
BE	Bashkimi Evropian
DRPRIH	Departamenti për Ri integrim të Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve
DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit
EPPRM	Ekipi për Parandalim dhe Reagim për Mosbraktisje
KA	Komisioni për Ankesa
KASH	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve
KKR	Komisioni Komunal për Ri integrim
MATP	Masat Aktive të Tregut të Punës
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MASHTI	Ministria e Arsimit, Shkencës,Teknologjisë dhe Inovacionit
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MPJD	Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës
MFPT	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
MKK	Ministria për Komunitete dhe Kthim
MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MSA	Marrëveshja e Stabilizim Asocimit
PR	Person i Riatdhesuar
PIR	Plani Individual i Ri integrimit
PII	Plani Individual i Integrimit
QAP	Qendrat e Aftësimit Profesional
QPS	Qendrat për Pune Sociale
SMR	Sistemi për Menaxhimin e Rasteve
ZKKK	Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim
ZP	Zyrat e Punësimit
ZGJC	Zyra e Gjendjes Civile

HYRJE

Qeveria e Republikës së Kosovës e ka aprovuar Strategjinë për Mingrim 2021 - 2025, Rregulloren (QRK) Nr.22/2020 Për Riintegrimin e personave të Riatdhesuar si dhe bazuar në Rregulloren për Integrimin e të Huajve (Rregullore (QRK) Nr. 09/2019 për integrimin e të huajve është miratuar në mbledhjen e 110 te Qeverise së Kosovës, me vendimin nr. 01/110, date 11.07.2019).

Në kuadër të Agjendës Evropiane të Kosovës, kriteret nga Udhërrëfyesi për Liberalizimin e Vizave të përcaktuara në Bllokun 0, Ri pranimi dhe Ri integrimi tashmë janë përmbushur. Gjatë hartimit të Strategjisë për Ri integrim, janë adresuar të gjitha kërkesat që dalin nga Programi Kombëtar për Zbatimin e MSA-së.

Strategjia e Ri integrimit ka për qëllim ri integrimin e qëndrueshëm socio-ekonomik të personave të riatdhesuar përmes avancimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të një sistemi efektiv e efikas të shërbimeve, të fokusuar në nevojat e të kthyerve.

Strategjia, si dokument qeveritar i politikave të ri integrimit është obligative të zbatohet në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Në kuadër të Planit te Veprimit te Strategjisë është paraparë edhe hartimi i Planeve Komunale për Ri integrim të qëndrueshëm. Me qëllim të zbatimit të koordinuar në praktikë të Strategjisë për Migrim 2022 - 2025, Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKKK) në bashkëpunim me Drejtoritë Komunale si dhe me përfaqësuesit e organizatave vendore e ndërkombëtare, si Grupi Punues, kanë hartuar Planin Komunal për ri – integrim të qëndrueshëm dhe Integrimin e të huajve për Komunën e Kaçanikut.

Plani i Veprimit përmban objektivat, aktivitetet konkrete dhe masat për arritjen e objektivave, përcakton institucionet përgjegjëse dhe mbështetëse për arritjen e secilit objektiv, saktëson kornizën kohore për realizimin e secilit aktivitet, koston e përafërt financiare për zhvillimin e aktiviteteve, indikatorët matës të objektivave dhe aktiviteteve dhe mjetet e verifikimit.

Plani është hartuar në bazë të Strategjisë për Mingrim 2021 – 2025, Rregulloren (QRK) Nr.22/2020 Për Riintegrimin e personave të Riatdhesuar si dhe bazuar në Rregulloren për Integrimin e të Huajve (Rregullore (QRK) Nr. 09/2019 për integrimin e të huajve është miratuar në mbledhjen e 110 te Qeverise së Kosovës, me vendimin nr. 01/110, datë 11.07.2019) dhe Planit të veprimit në nivel shtetëror, në bashkëpunim të ngushtë me MPB/DRPRIH si institucion përgjegjës për ri integrim në nivel nacional, dhe në vete ngërthen strukturën e saj, mirëpo duke pasur parasysh se ka të bëjë me nevojat e personave të riatdhesuar në Komunën e Kaçanikut, përmban edhe aktivitetet specifike për vetë komunën dhe është e bazuar në të dhënat e siguruara nga Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim. Kështu, ne këtë Plan është mundësuar integrimi maksimal i gjitha aktiviteteve për arritjen e ri integrimit të qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në komunën e Kaçanikut.

Plani Komunal i Veprimit për riintegrimin dhe integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe të huaj 2026-2028								
Objektivi 1:			*Indikatorët për matjen e arritjes së objektivit*			*Baza*	*Caku 2026*	*2028*
Avancimi i sistemit të ri integrimit për personat e riatdhesuar dhe të huajve, duke aplikuar qasjen e orientuar në nevojat specifike për riintegrimin e personave te riatdhesuar dhe integrimin e të huajve			• *Janë identifikuar nevojat e grupeve të cenueshme dhe shërbimet ofrohen bazuar në planin individual të riintegrimit dhe te integrimit;* • *Shërbimet e riintegrimit dhe integrimit monitorohen sistematikisht dhe ndërmerren masat e nevojshme përmirësuese;* • *Është arritur riintegrimi dhe i integrimit qëndrueshëm socio ekonomik i grupeve të cenueshme;*			*40%* *50%* *30%*	*60%* *70%* *50%*	*80%* *80%* *70%*
#	**Masa**	*Veprimet*	*Indikatorët*	*Institucioni përgjegjës*	*Institucioni /partneri përkrahës*	*Kosto financiare*	*Afati kohor*	*Mjetet e verifikimit*
1.1	Identifikimi i nevojave të grupeve të cenueshme;	1. Realizimi i vizitave në familjet e kthyera, apo të posa ardhurve të huaj brenda 72 orëve pas kthimit, apo pas marrjes së statusit/leje qëndrimit në Kosovë, bashkërisht me përfaqësuesin e DRPRIH dhe QPS; 2. Intervisto familjen dhe plotëso formularin e Vlerësimit të Nevojave;	NR. i familjeve të cenueshme të kthyera, dhe të huaja në komunë Nr. vizitave të realizuara nga ekipi për VN Nr. i FVN të plotësuar Nr. i formularëve të vendosur në SMR	ZKKK DRPRIH/MPB/QPS	DRPRIH/MPB Specialist shëndetësor Policia në komunitet - (Sipas nevojës) Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë		Në vazhdimësi	Raportet nga tereni FVN i Plotësuar dhe nënshkruar nga palët SMR

		3. Vendos FVN të skanuar në SMR						
1.2	Hartimi i planit individual të ri integrimit dhe integrimit, bazuar në pakot standarde të shërbimeve dhe nevojat e identifikuara ne FVN;	Harto Planin Individual të ri integrimit dhe integrimit për secilin person dhe familje të cenueshme, në bashkëpunim të ngushtë me drejtoritë përkatëse komunale; Vendose PIR/PII të skanuar në SMR;	Nr. i Planeve Individuale të ri integrimit dhe integrimit, të hartuara;	ZKKK/QPS/ DRPRIH/MPB	ZP Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë	KA	Në vazhdimësi	Planet Individuale të ri integrimit dhe integrimit në SMR
1.3	Zbatimi i planit individual të ri integrimit dhe integrimit përmes ofrimit i shërbimeve të ri integrimit të qëndrueshëm për grupet e cenueshme;	Këshillo personin e riatdhesuar dhe të huajin për parashtrim të kërkesave dhe informoje për afatet ligjore te parashtrimit te kërkesave; Ndihmo PR në plotësimin e kërkesave dhe dokumentacionit; Bashkëpuno me drejtoritë përkatëse komunale për sigurimin e shërbimeve të nevojshme; Regjistro kërkesat dhe përfitimet në	Nr. i kërkesave te parashtruara, bazuar në PIR; Nr. dhe llojet e skemave të mbështetjes; Nr. i kërkesave dhe përfitimeve të regjistruara ne SMR;	ZKKK DRPRIH/MPB	Drejtoritë komunale përkatëse DRPRIH/MPB ZP QAP Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë	BRK - Buxheti i ri integrimit dhe integrimit	Në vazhdimësi	Raportet e rregullta Kërkesat e parashtruara SMR

		SMR;						
1.4	Monitorimi dhe vlerësimi periodik i ri integrimit dhe integrimit të qëndrueshëm për grupet e cenueshme;	Monitoro në baza mujore zbatimin e PIR; Vlerëso në baza tremujore skemat e ofruara, ndikimin e tyre dhe nevojat për plotësime apo ndryshime të skemave për arritjen e ri integrimit të qëndrueshëm dhe integrimit;	Nr. i raporteve mujore të monitorimeve dhe vlerësimeve; Raporti tremujor i vlerësimit të ndikimit te skemave të ri integrimit dhe integrimit, me rekomandimet konkrete për masa shtesë, në rast nevoje;	ZKKK DRPRIH/MPB/anëtarët e komisionit	Drejtoritë komunale përkatëse ZP Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë		Në vazhdimësi	Raportet e tremujore të monitorimit dhe vlerësimit
1.5	Vlerësimi përfundimtar i ri integrimit dhe integrimit dhe mbyllja e rastit;	Vlerëso gjendjen përfundimtare dhe nivelin e ri integrimit dhe integrimit te PR sipas PIR; Mbylle rastin në dokumentacion fizik; Mbyll rastin në SMR- konstato - ri integrim / integrim i qëndrueshëm;	Nr. i raporteve të vlerësimit përfundimtar për secilin person/familje; Numri i rasteve të mbyllura në dosje fizike; Numri i rasteve të mbyllura në dosje fizike SMR	ZKKK- QPS	DRPRIH/MPB ZP Drejtoritë komunale përkatëse Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë	KA	Në vazhdimësi	Raportet e mbylljes së rasteve pas 18 muajve; Dosjet fizike të PR, të mbyllura SMR
Objektivi specifik: 2			***Indikatorët për matjen e arritjes së objektivit***			***Baza***	***Caku 2026***	***2028***
Avancimi i sistemit të referimit të rasteve në skemat adekuate të ri integrimit të personave të riatdhesuar dhe integrimit të të huajve			• *Sistemi i referimit dhe koordinimit ndërmjet akterëve komunal është i vendosur dhe funksional;* • *Numri i rasteve të referuara tek autoritetet relevante komunale, bazuar në profilin e tyre është rritur;*			*40 %* *40 %*	*70%* *75%*	*90%* *90%*

			• *Rritet numri i drejtorive komunale të ndërlidhura me SMR*			*30 %*	*60 %*	*80 %*
#	***Masa***	***Veprimet***	***Indikatorët***	***Institucioni përgjegjës***	***Institucioni /partneri përkrahës***	***Kosto financiare***	***Afati kohor***	***Mjetet e verifikimit***
2.1	Vendosja e një sistemi funksional të referimit dhe koordinimit ndërmjet akterëve komunal;	Koordino ndihmën dhe mbështetjen me drejtoritë relevante komunale, ne baza ditore, për secilin rast; Realizo takime te rregullta dhe takime ad-hoc, diskuto rastet që kërkojnë zgjidhje;	Nr. i rasteve të referuara ne drejtorit përkatëse komunale; Nr. i takimeve te rregullta dhe numri i rasteve te diskutuara; Nr. i takimeve ad –hoc dhe numri i rasteve te diskutuara;	ZKKK DRPRIH/MPB	DRPRIH/MPB MAPL MPFVLÇ MSH MBPZHR QPS ZP Drejtoritë komunale përkatëse Qendra e Shëndetit mendor Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Kosovë	KA	Në vazhdimësi	SMR Raportet e rregullta nga tereni Raportet e rregullta nga DRPRIH/MPB ZKKK
2.2	Profilizimi i të riatdhesuarve dhe të huajve, vlerësimi i nevojave pas arritjes në komuna;	Pranimi në zyrë i personave të riatdhesuar apo të huaj; Intervisto të riatdhesuarin/të huajin, parashtro pyetje rreth nevojave dhe mundësive të	Nr. i personave të lajmëruar në ZKKK; Nr. i personave të intervistuar; Nr. i dosjeve me profilin personave të riatdhesuar dhe te huaj;	ZKKK DRPRIH/MPB	DRPRIH/MPB ZP Drejtoritë përkatëse komunale	KA	Në vazhdimësi	Raportet e DRPRIH/MPB ZKKK SMR

		tij/saj; Krijo profilin e secilit person të kthyer apo te huaj; Vlerëso dhe evidento nevojat e tij/saj; Vendos profilin dhe nevojat në SMR;	Nr. i personave me nevojat e vlerësuara; Nr. i personave me profilin e vendosur ne SMR					
2.3	Referimi i personave të riatdhesuar dhe të huajve tek autoritetet relevante komunale bazuar në nevojat dhe profilin e tyre;	Refero personat në drejtoritë përkatëse për marrjen e shërbimeve p.sh: Refero në ZGJC personat qe kanë nevojë për dokumentacion civil; Refero personat e kthyer, apo të huaj në ZP që të regjistrohen si punëkërkues; Refero personat e kthyer apo të huaj të cenueshëm në QPS; Refero në DKA personat e kthyer apo të huaj që kanë fëmije për informim dhe asistimin e tyre për regjistrimin e tyre në shkolla;	Nr.i personave të referuar në drejtoritë përkatëse; Nr .i personave te referuar në ZGJC; Nr.i personave te referuar në ZP; Nr.i personave te referuar në QPS; Nr.i personave te referuar në DKA;	ZKKK	DRPRIH ZP QPS QAP Drejtoritë komunale përkatëse Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë	KA	Në vazhdimësi	Raportet e DRPRIH/MPB ZKKK SMR

2.4	Përmirësimi i sistemit të këshillimit të personave të riatdhesuar apo të huaj pas arritjes në komunë;	Bazuar në profilin dhe nevojat, këshillo ata për mundësitë e përfitimit nga shërbimet publike dhe skemat e ri integrimit dhe të integrimit; Këshillo dhe oriento ata se cilat dokumente ju nevojiten për çfarë shërbimi; Ndihmo ne përgatitjen dhe kompletimin e kërkesave; Këshillo për respektimin e afateve dhe detyrimet ligjore; Njofto ata për pasojat ligjore të ri emigrimit;	Nr. i personave të këshilluar nga ZKKK Nr. i personave qe janë ndihmuar për përgatitjen dhe kompletimin e dokumenteve	ZKKK	DRPRIH/MPB QPS ZP QAP Drejtoritë përkatëse komunale Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë		Në vazhdimësi	Raportet e DRPRIH/MPB ZKKK SMR
2.5	Ndërmarrja e masave me akterët relevant për gjurmim, referim dhe këshillim të personave të riatdhesuar dhe të huaj;	Vendos sistem të bashkëpunimit të rregullt me Policinë në komunitet, me grupet në komunitet, me shkollat, organizatat; Kërko që të	Takimet e rregullta me akterët relevant Numri i të riatdhesuarve	ZKKK	DRPRIH Policia e Kosovës Shkollat QPS ZP Drejtoritë komunale përkatëse		Në vazhdimësi	Raportet e DRPRIH/MPB ZKKK Numri i të riatdhesuarve dhe te huajve të identifikuar

		informohesh nëse ndonjë person apo familje është kthyer/ apo person apo familje e huaj ka marre statusin e mbrojtjes ndërkombëtare apo leje qëndrim, e nuk është identifikuar në SMR dhe/apo nuk është lajmëruar në zyrën tuaj; Kontakto personin e kthyer apo te huajin informo për mundësitë e mbështetjes, refero në institucionet përkatëse;	dhe te te huajve që identifikohen si rezultat i këtij bashkëpunimi		Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë			
2.6	Monitorimi dhe vlerësimi i sistemit të referimit dhe koordinimit;	Realizo takime te rregullta me ZKKK; Diskutoni për referimin dhe koordinimin e rasteve; Analizo sistemin e referimit dhe koordinimit; Vlerëso gjendjen aktuale dhe Rekomando masa përmirësuese, në rast nevoje;	Nr. i takimeve të rregullta	ZKKK DRPRIH/MPB	ZP QPS Drejtoritë komunale përkatëse Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë		Në vazhdimësi	Raportet monitoruese

2.7	Referimi i rasteve pas periudhes 12 mujore sipas legjislacionit në fuqi.	Identifikimi i personave / familjeve qe kane nevoje per mbeshtetje pas 12 muajve. Ndërmarrja e veprimeve për planifikim buxhetor për vazhdimin e akomodimit dhe masave tjera te nevojshme pas 12 muajve.	Vizita personave / familjeve në skemën e akomodimit dhe me nevoja specifike pas periudhes 12 mujore Takime dhe informim për rastet me drejtoritë përgjegjëse në mënyrë që të bëhet planifikimi buxhetor	ZKKK QPS Drejtoritë përgjegjëse	DRPRIH ZP	/	Në vazhdimësi	Raporte të rregullta

Objektivi specifik 3	***Indikatorët për matjen e arritjes së objektivit***	***Baza***	***Caku 2026***	***2028***
Avancimi i masave të ri integrimit dhe integrimit të qëndrueshëm ekonomik	• *Numri i punëkërkuesve të riatdhesuar apo te huaj të profilizuar dhe të këshilluar për zhvillimin në karrierë;* • *Numri i të riatdhesuarve/huajve të punësuar;* • *Numri i përfitueseve të vetëpunësimit dhe shërbimeve të konsulencës;* • *Numri i përfituesve nga skemat e aftësimit profesional;* • *Numri i të riatdhesuarve/te huajve përfitues të grandeve bujqësore dhe këshillimeve në fushën e bujqësisë;* • *Numri i të riatdhesuarve/te huajve të mbështetur nga komuna me material dhe mjete bujqësore;* • *Zgjerimi i fushave të aftësimit profesional në përputhje me nevojat e tregut*	*60%*	*70%*	*90%*

%	*Masat*	*Veprimet*	*Indikatorët*	*Institucioni përgjegjës*	*Institucioni /partneri përkrahës*	*Kosto financiare*	*Afati kohor*	*Mjetet e verifikimit*
3.1	Regjistrimi i të riatdhesuarve/të huajve si punëkërkues në Zyrat e Punësimit;	Prano në zyrë personin e riatdhesuar/të huaj; Regjistro personat e riatdhesuar/te huaj si punëkërkues; Informo ata për të drejtat e tyre dhe mundësitë e mbështetjes me MATP; Informo ata për mundësitë e tyre në baze të legjislacionit në fuqi;	Nr. i personave të riatdhesuar apo te huaj të regjistruar si punëkërkues;	APRK-ZP	DRPRIH/MPB ZKKK QAP Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë	/	Në vazhdimësi	Raportet e ZP Raportet e ZKK
3.2	Profilizimi dhe këshillimi për zhvillim në karrierë i punëkërkueseve të riatdhesuarve apo te të huajve;	Intervisto atë, parashtro pyetje rreth mundësive dhe nevojave të tij/saj; Vlerëso dhe evidento nevojat e tij/saj Krijo profilin e secilit person të kthyer apo të huaj Këshillo ata për orientim ne karriera, bazuar ne aftësitë dhe mundësit e tyre Krijo një dosje për secilin person te	Numri i personave të riatdhesuar, te huaj të cilëve u janë vlerësuar nevojat e tij/saj; Nr i dosjeve fizike të personave të riatdhesuar apo te huaj që janë këshilluar në ZP dhe nevojat e tyre jane evidentuar; Numri i të riatdhesuarve apo te huajve punëkërkues ku janë vendosur shënimët për profilizim dhë këshillim në SMR	ZP	ZKKK QAP	/	Në vazhdimësi	Raportet e ZP Numri i dosjeve Shënimët dhe raportet nga SMR

		riatdhesuar apo te huaj Vendos shënimet në SMR						
